

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7576 E hënë 2 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Edhe pse shprehja 'gjuha e urrejtjes' është bërë shumë e zakonshme, nuk ka ende një përcaktim të saktë se çfarë në të vërtetë është 'gjuha e urrejtjes' ...
Vijon në faqen 20

Nga MONIKA STAFA

Gjuha e urrejtjes- rastet krahasuese në raportet europiane



Opinion **i** Ditës

Pas Luftës së Dytë Botërore, me krijimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Bretton Woods, New Hampshire 1944, fokusi i përpjekjeve ...
Vijon në faqen 21

Nga Elvis Zaimi

Politikat e zhvillimit dhe reforma rregullatore



Spaho: U qëllua me tre plumba. Rama: Skenar makabër

Vetëvrasia e shoferit të Xhafajt, ekspertiza: Shkëlzen Qordia ka marrë 1 plumb në kokë

Pak orë para ngjarjes gardisti ka qenë duke festuar në një nga klubet e natës në kryeqytet

Çdo qytetar apo emigrant që dëshiron të derdhë kontribut vullnetar në Shqipëri për të marrë pension pleqërie mund të përfitojë zbritje nëse parapaguan për vitin korrent. Kështu, nëse qytetarët duan të blejnë vitet e punës ...

Në faqen 2-4

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE: SHEMBUJT KONKRETE SA DO JU TAKOJE

PENSIONET E PLEQERISE, ISSH: SI T'I LLOGARISNI

"Formula e saktë dhe kategoritë e të moshuarve që mund të marrin më shumë para. Cilat janë kushtet që duhet të plotësojnë për ta përfituar"



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqen 9

SOT VENDIMI

Denoncimi i PD-së, Çupi: Dhëndurët e ish-byroistëve po emërohen ambasadorë

Në faqen 5

LIFEPAGES

Ylli Merja: Çaji që shkrin gurët në veshka brenda 2 javësh, ja si ta përdorni

Suplement

DOSSIER

"Vrasja e deputetit Hysni Toska më 1943 nga një mafie lokale komunisto-balliste"

Në faqen 18-19

NDRYSHIMET

Urgjencat kirurgjikale, një herë në javë te Sanatoriumi, Brataj: Telefononi te 127

Në faqen 12

DEKLARATA E MINISTRIT GJERMAN, HEIL



Gjermania kërkon 50 mijë punonjës për shëndetësinë, viza dhe për shqiptarët

Në faqen 7

INTERVISTE/ Plagosja e trefishtë në Kinostudio, flet mamaja e vëllezërve Mumajesi

"S'e dimë çfarë ngjau, ja historia e djemve të mi"

Mumajesi: Juxhini ndryshoi mbiemër për shkak të nënshtetësisë franceze

Nga INA ALLKANJARI

Do duhej shiu i rrëmby-der në Tiranë, kushtet e vështira ku ruhen librat dhe ngushtësia e mjediseve të Bibliotekës Kombëtare, që njerëzit të kuptonin edhe njëherë emergjencën e saj. Këtë herë, drejtoresha e in-



stitucionit ka qenë disi pa doreza. Nuk kemi ambiente, kushtet janë të vështira, ishte me pak fjalë ajo që parash-troi në këto orë të vështira. Ndërkaq, nuk ka mundur t'i shpëtojë politikës dhe aku-zave ndaj saj gjendja aktuale e Bibliotekës ...

Në faqen 7

SHOFERI I MINISTRIT HETIMET

Pak para vetëvrasjes Qordja ka qenë duke festuar në një nga klubet e kryeqytetit

Vdekja e gardistit, ekspertiza: Ka marrë 1 plumb në kokë


Dërgohet për verifikim automatiku i llojit MP5

Një ditë pas vdekjes së gardistit Shkëlzen Qordja, i cili ishte dhe shoferi i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj del ekspertiza mjeko-ligjore. Pas dyshimeve se Qordja është vetëvrasës, ekspertiza konfirmon se 31-vjeçari kishte marrë vetëm një plumb kokë në pjesën e lobit temporal. Mësohet se plumbin, e ka marrë në pjesën anësore të kokës, më saktë në anën e djathtë, ku edhe iu gjet arma. Bëhet fjalë për një armë automatik të llojit MP5. Ndërkohë grupi hetimor ka dërguar për ekspertizë automatikun MP5, për të verifikuar nëse në këtë armë ka gjurmë të tjera gishtash, përveçse të shoferit të Fatmir Xhafajt, për të hequr çdo dyshim nëse kemi të bëjmë me vetëvrasje ose jo. Gjithashtu, në sediljen e mjetit u gjetën 3 gëzhoja. Sipas policisë, nga të cilët vetëm njëri ka shkaktuar vdekjen e gardistit.

Po ashtu 31-vjeçari rezultoi se pak orë para se të parkonte automjetin ku u vetëvra në mjediset e gardës, ka qenë duke festuar në një nga klubet e natës në kryeqytet. Ky version konfirmohet edhe nga të afërm të 31-vjeçarit, i cili sipas tyre kishte postuar edhe video në rrjetet sociale. Ndërkohë 31-vjeçari është përcjellë mesditën e djeshme për në banesën e fundit. Të tronditur nga ngjarja e rëndë, familjarët nuk kanë dhënë reagim për mediat.

HETIMI

Grupi hetimor është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave. Mësohet se hetuesit e çështjes kanë sekuestruar kamerat e sigurisë së Gardës së Republikës, ndërsa janë marrë në pyetje edhe përgjegjësit e tur-



31-vjeçari Shkëlzen Qordja

nit në këtë institucion. Kolegët e 31-vjeçarit janë shprehur se nuk e kanë parë të shqetësuar ditët e fundit. Ditën e djeshme menjëherë pas ngjarjes reagoi nëpërmjet një njoftimi për mediat Garda e Republikës. "Ditën e shtunë rreth orës 09:30 të mëngjesit, në garnizonin e Gardës së Republikës është gjetur i pajetë brenda garazhit, të caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, gardisti me detyrë funksionale shofer i

ministrit të Brendshëm, Shkëlzen Qordja, 31 vjeç. Trupi i pajetë u konstatua nga punonjës të Gardës. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave". -thuhet në njoftim. Por, pavarësisht deklaratave zyrtare të Gardës së Republikës dhe të Policisë së Shtetit, ngjarja është e veshur me mister. Kjo

për faktin se ende nuk dihet saktësisht se kur hyri Qordja brenda ambienteve të Gardës, nëse ka qenë i vetëm, i shoqëruar, me makinë apo në këmbë. Nuk dihet saktësisht se kur ka qëlluar veten dhe pse mbante armë automatike me vete. Po ashtu nuk bëhet me dije nëse janë dëgjuar krisma, apo arma ka qenë me silenciator. Pritet që hetimet të hedhin dritë mbi këtë ngjarje që tronditi Tiranën.


Vetëvrasja e 31-vjeçarit me armën e shërbimit, si ndodhi ngjarja

Shkëlzen Qordja kishte nisur punë në Gardën e Republikës në mars të vitit të kaluar, ndërsa punonte prej më shumë se 6 vitesh si shofer personal i Fatmir Xhafaj. 31-vjeçari Qordja u gjet i vdekur në orët e para të mëngjesit e pardjeshëm në garazhin e Gardës së Republikës. Në një njoftim për mediat Policia e Shtetit sqaroi se dyshohet se është vetëvrasës. "Policia e shtetit është njoftuar nga Garda e Republikës rreth orës 09:30 të mëngjesit se në garnizonin e Gardës është gjetur i pajetë gardisti me detyrë funksionale shofer i ministrit të



Brendshëm, Shkëlzen Qordja, 31-vjeç. Menjëherë është ngritur grupi hetimor, nën drejtimin e prokurorit të rrethit Gjyqësor Tiranë, me përbërje oficerë të Policisë Gjyqësore, ekspertë mjeko-ligjorë, ekspertë të krimnalistikës dhe hetues të SHÇBA-së. Nga veprimet e para hetimore rezultoi se në mjetin e Gardës u gjet i pajetë në sediljen e sho-

ferit, punonjësi Shkëlzen Qordja. Makina ishte e parkuar në garazh e caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme e mbyllur nga brenda. Nga këqyrja rezultoi se në kokën e viktimës ka plagë tejshpuese të shkaktuara nga armë zjarri, me qitje me drejtim nga e djathta në të majtë", -thuhet në njoftimin e policisë.



GARDA E REPUBLIKËS

Ditën e shtunë rreth orës 09:30 të mëngjesit, në garnizonin e Gardës së Republikës është gjetur i pajetë brenda garazhit, të caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, gardisti me detyrë funksionale shofer i ministrit të Brendshëm, Shkëlzen Qordja, 31 vjeç. Trupi i pajetë u konstatua nga punonjës të Gardës. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave.



KAMERAT E SIGURISË

Nga veprimet e para hetimore rezultoi se në mjetin e Gardës u gjet i pajetë, i ulur në sediljen e mjetit, punonjësi Shkëlzen Qordja. Makina ishte e parkuar në garazhin e caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme dhe u gjet e mbyllur nga brenda. Nga këqyrja rezultoi se në kokën e viktimës ka plagë tejshpuese të shkaktuara nga armë zjarri, me qitje me drejtim nga e djathta në të majtë. Mësohet se hetuesit e çështjes kanë sekuestruar kamerat e sigurisë së Gardës së Republikës, ndërsa janë marrë në pyetje edhe përgjegjësit e turnit në këtë institucion.



Garda e Republikës

Ylli Manjani

"Ndërkohë që fajëson opozitën për "mos respektim të kodit të vdekjes", vetë i shpreh gjasme-ngushëllimet në miting politik! Faqezi sa më s'ka! Shko të paktën pije një kafë në shtëpinë e të ndjerit dhe HESHT! Është varrë, ndër të tjera, një punonjës i Sigurisë së Shtetit",-shprehet z.Manjani.



Vetëvrasja e gardistit, Vasili Rama, heton para prokurorisë

Kreu i Grupit të LSI, Petrit Vasili akuzoi kryeministrin Edi Rama se bën edhe rolin e prokurorit. Vasili në një status në Facebook shkruan se "kryeministri mbaroi edhe hetimet për vrasjen e shoferit të ministrit të Brendshëm" ndërkohë që prokuroria s'ka nxjerrë ende një qëndrim përfundimtar. Vasili tha se ndërkohë që organet përkatëse nuk kanë nxjerrë akoma asnjë përfundim rreth ngjarjes, kryeministri Rama e ka sikletin shumë të madh dhe po i imponon prokurorisë së ç'duhet të thotë. "Çfarë sikleti të madh ka kryeministri, që sërisht bëhet prokuror. Kryeministri i mbaroi vetë hetimet, dha edhe përfundimet për ngjarjen e rende të shoferit të ministrit të Brendshëm. Ç'siklet ka kryeministri që nxiton kaq shumë të flasë, të bëjë hetuesin edhe prokurorin? Prokuroria po heton, po bën punën e saj dhe nuk ka nxjerrë akoma një qëndrim përfundimtar. Kaq të madh e ka sikletin kryeministri, që po nxjerr përfundime dhe po i imponon prokurorisë së ç'duhet të thotë. Ç'siklet ka kryeministri që nuk flet se si ngjarja ndodhi brenda institucionit të sigurisë më të lartë në vend? Ky kryeministër i inkriminuar ka shumë siklete të cilat po dalin, por edhe do vazhdojnë të dalin një nga një", shprehet kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së.

"Për të fshehur një vrasje mafioze, Edi Rama ka marrë publikisht rolin e kryeprokurorit"

PD, Spaho: Shoferi i ministrit Xhafaj u qëllua me 3 plumba

"Ngjarja tragjike, është vrasje mafioze"

Valentina Madani

Partia Demokratike e konsideron vrasje mafioze ngjarjen tragjike të punonjësit të Gardës, Shkëlzen Qordja. Kreu i Grupit të PD, Edmond Spaho, nga selia blu, hodhi poshtë pretendimet e kryeministrin Rama nga Korça se me vdekjen e Shkëlzen Qordjes po abuzohet politikisht, kur gardisti, shofer i ministrit të Brendshëm, në të vërtetë kishte kryer vetëvrasje. Spaho, në një deklaratë për mediat nga selia blu, tha se shoferi i ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj është vrarë me 3 plumba. Ai akuzoi kryeministrin Edi Rama dhe qeverinë se po mundohen të mbulojnë këtë ngjarje, duke e klasifikuar si vetëvrasje. Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së Edmond Spaho tekua iu kundërpërgjigj kryeministrin deklaroi se vrasja e 31-vjeçarit nuk është skenar fantazie, siç do ta shesë kryeprokurori Edi Rama. Sipas Spahos, Rama mohon këtë gjë ashtu siç mohoi avionët e drogës, përfshirjen e Tahirin në trafik ndërkombëtar drogë apo dënimin e Agron Xhafajt. Shkëlzen Qordja u gjet i pajetë mëngjesin e 30 qershorit në ambientet e Gardës së Republikës. Policia e Shtetit tha zyrtarisht se 31-vjeçari kishte vrarë veten me 3 plumba të një arme automatike. Spaho deklaroi prerë: "Ngjarja tragjike me shoferin e ministrit të Brendshëm është vrasje mafioze, nuk është skenar fantazie, siç do ta shesë kryeprokurori Edi Rama". "Këto 5 vjet në pushtet Edi Rama ka mohuar çdo skandal që implikon atë dhe qeverinë e tij në krim! Edi Rama quajti skenar fantazie edhe transportin e drogës me avionë. Ai tha se kriminelet në parlament dhe bashki ishin skenarë makabër të opozitës. Kanabizimin e vendit Edi Rama e quajti njësoj si sot, skenar fantazie makabër. Përfshirjen e Saimir Tahirit me 'Audin' e tij 'AA 003 GB' në trafikun ndërkombëtar të drogës bashkë me Habilajt, Edi Rama e cilësoi skenar kriminal të opozitës. Edi Rama mohoi për 5 vjet dënimin e Agron Xhafajt,



Kreu i Grupit të PD, Edmond Spaho

KUNDËRPËRGJIGJJA

"Ngjarja tragjike me shoferin e ministrit të Brendshëm është vrasje mafioze, nuk është skenar fantazie, siç do ta shesë kryeprokurori Edi Rama",-tha z.Spaho.

vëllait të ministrit të Brendshëm, për trafik ndërkombëtar drogë. Tani, po mohon, me të njëjtat fjali, përfshirjen e Taulant Ballës, në pastrimin e parave të drogës me çështjen e 3.4 milionë eurove, të kapura në "Toyota Yaris" vetëm pasi u denoncuan nga opozita",-tha z.Spaho. Sipas tij

mohimi i këtyre të vërtetave e la Shqipërinë jashtë Europës! Sepse më vend të së vërtetës dhe të Europës, Edi Rama zgjodhi Saimir Tahirin, Taulant Ballën, bashkëqeverisjen me krimin dhe drogën, duke tradhtuar interesat e shqiptarëve. "Me Edi Ramën kryeministër dyert e Eu-

ropës do të vazhdojnë të jenë të mbyllura edhe qershorin tjetër. Edhe për faktin se, për të fshehur një vrasje mafioze, Edi Rama ka marrë publikisht rolin e kryeprokurorit, duke paracaktuar se vrasja mafioze ishte vetëvrasje me 3 plumba",-theksoi kreu i deputetëve të PD-së.

"Kryeprokuror Rama lan duart nga Korça si Pilati"

Denoncimi te Berisha: Vrasja e shoferit të Xhafajt nga dy vetë, vrasje shtetërore

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje në Korçë, se shoferi i Fatmir Xhafajt është vetëvrasë dhe jo vrarë. Por ish-kryeministri Sali Berisha e akuzon atë se po lan duart si "Pilati" tekua publikon denoncimin e një qytetari, sipas të cilit, vrasja e shoferit të Xhafajt është bërë nga dy vrasës dhe se është vrasje shtetërore. "Krye, Krye, Kryeprokuror Edvin Rama lan duart nga Korça si Pilati! Vrasja brenda në Gardë e shoferit të familjes mafioze Xhafaj, është realizuar nga dy vrasës dhe është vrasje shtetërore! Sb. "Përhëndetje doktor nxitimi i kryeministrin për të shpallur vetëvrasje ekzekutimin mafioz të shoferit të ministrit Xhafaj



është dëshmi e vendosmërisë së tyre për të fshehur me çdo kusht krimin e rende që u krye brenda Gardës ndaj një punonjësi të Gardës. Këtu në Gardë të gjithë jemi shumë të tronditur. Të gjithë e dinë se ai djalë dinte çdo gjë për Xhafajn dhe Don Agacion sikundër nuk dihet shkaku se

pse ministri së fundi ishte ftohur me të. Gardistët më thonë se mbremjen pas debatit të ashpër, sherrit dhe zënies tek aktiviteti i fundit që ka pasur me ministritin, për të cilin në Gardë e dinë shumë persona shoferi i zëmëruar në shoqërinë e një shoku ka shkruar në një nga lokalet në Tr ku thuhet që ai ka folur më shumë se ç'duhet, me pas i janë bashkuar edhe persona të tjerë. Do të gjej lokalin ku ai ka qëndruar dhe kush e ka shoqëruar pas bisedave, sepse nuk dinë të ma thonë. Këtu në Garde informacionet janë në duart e një grupi të ngushtë. ", thuhet në mesazhin dërguar ish-kryeministrin Berisha.

VDEKJA E GARDISTIT REAGIMET

Kryeministri i përplotur për shoferin e ministrit: Agresioni ndaj tij, i neveritshëm

Rama: Opozita skenar makabër me gardistin për të goditur Xhafajin

"Një sulm i tillë s'ndodhte as në mesjetë".

Kryeministri Edi Rama e konsideroi dje të neveritshëm reagimin e opozitës ndaj humbjes së jetës së punonjësit të Gardës. Pasi shprehu ngushëllimet familjes, kreu i qeverisë tha nga Korça se të afërmit e gardistit, u gjendën nën rrebeshin e zi të sulmeve politike, që dominojnë politikën. Ai e quajti të paimagjinueshme se si opozita i thotë familjes që djalin ia vranë mafiozët. Pa i fshehur emocionet, kryeministri i përplotur deklaroi se kjo nuk ndodhte as në mesjetë.

"Si mund t'i thuash dy prindërve ta vranë mafiozët djalin kur djali në kushtet e një gjendje që s'ka kush ta shpjegojë më dhe ai vetë nuk është më kryen vetëvrasje? Si mund t'ia bësh një gjë të tillë një familjeje? Kjo nuk perceptohej as një historinë e mesjetës.

Si mund të kërdisësh në radio, TV a thua se këtu s'ka fëmijë, familje që duhen ndihmuar apo të paktën lënë rehat? Duke u futur në çdo familje dhe thënë 1001 të zeza. Në këto kushte jemi", -tha kryeministri. Ai përmendi se qeveria e tij nuk ka bërë mrekulli, por janë të angazhuar me mish e shpirt. Kryeministri shpërtheu ndaj opozitës duke i quajtur Esad Pashë Toptanin të shekulli të 21-të. "Ne që të jemi të qartë nuk kemi bërë asnjë mrekulli. Kemi plot gjëra për të përmirësuar, kemi bërë gabimet tona. Nuk jemi engjëj, jemi shqiptarë si gjithë të tjerët, me të mirat dhe të metat. Por një gjë është e sigurt që në këtë punë jemi të angazhuar me mish e me shpirt, me aq sa dimë me aq sa mundemi. Po këta çaj janë, nga vijin këta, nga cili pyll i errët i historisë sonë kanë dalë. Çaj janë këta që na kanë risjellë Esad Pashë Toptanin në shek. e 21 në mesjetë



AKUZA

"Agresioni brutal ndaj djalit që u nda nga jeta, përfshirja e tij në një skenar makabër për të goditur ministrin e Brendshëm dhe qeverinë, vërtetë nuk ka fjalë për t'u komentuar.", - deklaroi z.Rama.

të parlamentit. Pa dallim seksi, burra e gra që flasin, pa ditur ku shkon fjala. Do bëhet teatri dhe 230 mln u vodhën. Po ajo aq kushton e gjitha. Ujku, ujku, çakalli bën kërdinë. Këta çakallit i marrin të keqen. Nuk di me çfarë t'i krahasoj", -deklaroi kryeministri.

NEGOCIATAT

Nga Korça, ku ishte për turin e llogaridhënies, kryeministri Edi Rama shprehu mirënjohjen për Greqinë dhe Italinë, që sipas tij punuan 1 mijë herë më shumë se opozita për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Bash-

kimin European. Ndërkohë çështjet e hipotekave dhe punësimi ishin ndër shqetësimet kryesore të korçarëve. Për vendimin që kryeministri e konsideron hapje negociatash pa kushte dhe me një datë në vitin 2019, mirënjohja shkon veçanërisht ndaj Greqisë dhe Italisë. "Ministri i Jashtëm i Greqisë ka luftuar njësoj sikur të ishte aty ministri i Jashtëm i Shqipërisë. Ata punuan 1 mijë herë më shumë se opozita, madje ajo punoi kundër", u shpreh Rama. Këtë fundjavë dha llogori në Korçë për qeverisjen. E famshma fabula e 'tepsisë' vazhdon edhe një vit pasi kryeministri Rama mori mandatin për të qeverisur i vetëm. Tepsia ka qenë infektuese -tha kryeministri, duke klasifikuar si ende më problematike çështjen e pronave. Rama njoftoi se Shqipëria ka hyrë në procesin e "shtet-bërjes" europiane dhe se qeveria bëri çka mundi. "Ne nuk e duam procesin e integritimit për t'u bërë anëtarë. Ky proces është themelor për të plotësuar shtet-bërjen, sepse ka dije kryesore. Do t'i bënim si me datë si pa datë. Ne sot në Shqipëri kemi numrin më të ulët të vrasjeve sipas statistikave.



Kryeministri Edi Rama dje në Korçë

Jemi tek mesatarja për numrin e vrasjeve në vit. Ky vit është edhe më i mirë. Ka edhe shumë gjëra të tjera për të bërë. Duan apo s'duan këta me propagandën terrorizuese të fundit të botës. Rrogat janë të ulëta, por kështu janë në të gjitha vendet e rajonit, por rrogat s'rriten me dëshirë. Dërdimënë që flasin pse s'rritin rrogat. Po mirë mo, po Gjermania pse s'i bën rrogat nga 10 mijë euro. Ne gjetëm një mal me borxhe. Efdendlerë që shajnë pa dallim, burra e gra. Esadistët e rinj të këtij vendi. Thonë se do popullin, kush mund të vijë këtu të harxhojë kohë për t'u tallur. Ka një rregull. Gratë të parat", -tha z.Rama.

Rama i premtos qytetares: Do të punësoj dy djemtë



Kryeministri Rama gjatë bashkëbisedimit me qytetarët dje në Korçë u përball me ankesën e një zonje, e cila kishte dy djemtë pa punë. Rama i premtos qytetares se në përfundim të takimit, të dy do shkojnë tek zyrat e punës. "Për një orë, ti dhe djemtë. Për të dy do mbarojmë tani takimin bashkë dhe do shikosh që e vërteta është ndryshe. Do të të ofrojnë vend punë, sepse kur dikush do punë, por punë ama, gjithmonë ka një mundësi. Sa të mbaroj takimin, ne bashkë do kemi provën e kësaj që të thashë", -tha z.Rama.

Negociatat, Berisha: Noriega dogji dy data, 2019 është e pasigurt

Ish kryeministri Sali Berisha akuzon pasardhësin Edi Rama se ka djegur dy data për hapjen e negociatave dhe sipas tij më e hidhura është se viti 2019, është i pasigurt. "E vërteta e hidhur është se qeveria e Noriegës ka djegur dy data për çeljen e negociatave: 13 dhjetor 2016 dhe 27 qershor 2018. Por akoma më e hidhur është se dhe fundi i vitit 2019 për Shqipërinë është një datë shumë më e



pasigurt për çeljen e negociatave me BE se sa ç'ishin dy datat që dogji Edvin Kristaq Gënjeshtra. Fundi i vitit 2019 për ne është shumë më i pasigurt, sepse ne me këtë qeveri dështake shkojmë drejt ti si

me një qeveri që ka mbetur dy herë në klasë. Fundi i vitit 2019 nuk është data e çeljes së negociatave, por është parashikuar si afati më i afërt i shqyrtimit të mundësisë së hapjes tyre në rast se janë plotësuar 13 kushtet", shprehet z.Berisha. Ish-kryeministri thekson më tej se: "Ata që pretendojnë apo besojnë se me Noriegën në krye të qeverisë dy herë ngelëse në klasë do hapen pas një vit e gjysmë negociatat e BE me

DEKLARATA

"Akoma më e hidhur është se dhe fundi i vitit 2019 për Shqipërinë është një datë shumë më e pasigurt për çeljen e negociatave me BE se sa ç'ishin dy datat që dogji Edvin Kristaq Gënjeshtra", -theksoi z.Berisha.

Shqipërinë, janë njerëz që u pëlqen të mashtrohen pasi verbërisht besojnë se ai që i ka mashtruar dy herë më parë nuk do të mashtrojë të tretën herë!?"

Çupi: Çuni i Sul Bushatit emëroi dhëndurët e Rita Markos, Lenka Çukos dhe mbesën e Kapos

Denoncimi i PD-së: Dhëndurët e ish-byroistëve, emërohen ambasadorë

"Rilindja si bashkim i krimit dhe diktaturës"

Valentina Madani

Emërimet e fundit në diplomaci, për Partinë Demokratike vijnë nga ish-Byroja Politike e Partisë Komuniste. Deputetja Dhurata Çupi akuzoi dje ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati se njësioi si i ati emëron në poste të rëndësishme diplomatike familjarët e ish-Byrosë Politike. Deputetja demokrate, Dhurata Çupi tha në një konferencë për shtyp se kreu i diplomacisë shqiptare ka dërguar në selitë tona diplomatike dhëndurët e Rita Markos, Lenka Çukos dhe mbesën e Hysni Kapos. Çupi tha se rasti i fundit është ai i emërimit të ambasadorit të Shqipërisë në Suedi të Virgjil Kule, dhëndri i Rita Markos. Po kështu ajo përmendi emërimin e mbesës së Hysni Kapos, ambasadore në UNESCO dhe dhëndrit të Lenka Çukos ambasador në Izrael. "Rilindja si bashkim i krimit dhe diktaturës, familjarët e ish-Byrosë Politike në poste diplomatike

Një nga kushtet që Shqipërisë t'i hapen negociatat qershorin e ardhshëm është dëryrimi i qeverisë për të ndërtuar dialog konstruktiv me opozitën! Por qeveria e ka shkatërruar që tani këtë prioritet, duke e shndërruar diplomacinë shqiptare në strehën e pinjollëve të ish-diktaturës komuniste. Ministri Ditmir Bushati, i biri i Sul Bushatit, zbaton të njëjtat kritere, siç bënte dikur i ati në diktaturë, duke emëruar familjarët e ish-Byrosë Politike në poste të rëndësishme diplomatike", deklaroi zj. Çupi. Ajo përmendi se rasti i fundit është ai i emërimit të ambasadorit të Shqipërisë në Suedi të Virgjil Kule, dhëndri i Rita Markos. Sipas PD-së ky emërim nuk është i rastësishëm! Mbesa e Hysni Kapos është emëruar ambasadore në UNESCO

Dhëndri i Lenka Çukos ambasador në Izrael. "Për të rinjtë që nuk i njohin, këta janë njerëzit që, bashkë me Enver Hoxhën, burgosën dhe vranë kundërshtarët e regjimit të tyre gjakatar, shtypën dhe sunduan për gati 5 dekada shqiptarët, duke na dërruar deri në mjerim, duke na grabitur pronën,



Deputetja Dhurata Çupi

EMËRIMET

"PD nuk do të njohë asnjë nga emërimet e lidhjeve të Edi Ramës me diktaturën komuniste dhe krimit! PD-ja, si një alternativë e rinisë, do t'i hapë rrugën të rinjve shqiptarë për një Shqipëri si gjithë Europa!", tha zj. Çupi.

duke na mohuar të drejtat dhe identitetin tonë europian. Asnjë nga këto emërimet nuk është rastës!

Edi Rama e konceptoi Rilindjen si bashkim mes krimit dhe pinjollëve e funksionarëve të regjimit komunist,

duke nisur nga ai vetë. Dhe bashkë me Gramoz Ruçin, Fatmir Xhafajn, Ditmir Bushatin, Ilir Beqajn, dhjetëra funksionarë të tjerë të lartë, me rikthimin në shërbimin sekret të oficerëve të Sigurimit të Shtetit, me portretin e Enver Hoxhës në festat zyrtare, Edi Rama ka ngritur sistemin kriminal të narkoenverizmit, një dik-

AKUZAT

Deputetja e PD-së Dhurata Çupi akuzoi ministrin Bushati se ka dërguar në selitë tona diplomatike dhëndurët e Rita Markos, Lenka Çukos dhe mbesën e Hysni Kapos. Ministri Ditmir Bushati, i biri i Sul Bushatit, zbaton të njëjtat kritere, siç bënte dikur i ati në diktaturë, duke emëruar familjarët e ish-Byrosë Politike në poste të rëndësishme diplomatike", -tha Çupi.

taturë e re që pushtetin e ka bazuar tek blerja e votës me paratë e drogës dhe të krimit", -u shpreh deputetja e PD-së. Dhurata Çupi bëri të qartë se "Partia Demokratike nuk do të njohë asnjë nga emërimet e lidhjeve të Edi Ramës me diktaturën komuniste dhe krimit! Partia Demokratike, si një alternativë e rinisë, do t'i hapë rrugën të rinjve shqiptarë për një Shqipëri si gjithë Europa!"

Bushati propozon sot para deputetëve tre emra për ambasadorë

Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati ka propozuar emrat e tre kandidatëve të tjerë për ambasadorë në Danimarkë, Moldavi dhe Mal të Zi. Të hënën në orën 12:00 pritet të mblihdet Komisioni për Politikën e Jashtme, ku do të zhvillohet një seancë dëgjimore me 3 kandidatë për ambasadorë, në Danimarkë, Moldavi e Mal të Zi. Përpara Komisionit të Politikës së Jashtme të drejtuar nga ish-ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, këta tre kandidatë pritet të japin sqarime për karrierën e tyre. Në rendin e ditës të këtij komisioni parashikohet: 1. Seancë dëgjimore me: Znj. Elida Petoshati, kandidat për Ambasador i Jashtëza-



konshëm dhe Fuqiplotë i Danimarkës; znj. Donika RSH-së në Mbretërinë e Hoxha kandidat për Am-

SEANCA

Sot në orën 12:00 pritet të mblihdet Komisioni për Politikën e Jashtme, ku do të zhvillohet një seancë dëgjimore me 3 kandidatë për ambasadorë, në Danimarkë, Moldavi e Mal të Zi.

basador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i RSH-së në Republikën e Bullgarisë, rezident si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i RSH-së në Republikën e Moldavisë, jorezident, z. Ridi Kurtezi kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i RSH-së në Republikën e Malit të Zi.

"Arat me hashash mbuluar", Boçi publikon pamjet në Vlorë



Deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi publikoi dje në rrjetet sociale një video të një are me hashash që sipas tij, është mbjellë në Vlorë. "FRESKIA E HASHASH-IT! Gjelbërimi me hashash vazhdon! Pamje nga Vlorë. Kjo është një video të cilën një mik ma postoi si dëshmi tronditëse të kriminalizimit të vendit. E shqëron me fjalë vetë, ku përcakton qartë dhe ditën me qëllim që "laboratori" i Ramës mos ta nxjerrë se është e vitit të kaluar! Hashash, drogë, krim, vrasje, grabitje prone publike e jo vetëm. Kjo është pamja e jetës "së lumtur" në vendin tonë ku ndërtohet banditizmi me forcat ... e qeverisë!", -shprehet z. Boçi.

Katër deputetë kosovarë marrin pasaportën shqiptare



Katër deputetë të parlamentit të Kosovës, Daut Haradinaj, Donika Kadaj Bujupi, Gani Dreshaj dhe Ahmet Isufi kanë marrë pasaportën shqiptare. Përmes dekretit të presidentit Ilir Meta katër deputetë gëzojnë të gjitha të drejtat brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj, sipas dekretit, nr. 10817, datë 25.6.2018, për dhënien e shtetësisë. Këto katër deputetë janë të fundit të një liste të gjatë zyrtarësh të Republikës së Kosovës, shkruan "Zëri", të cilën për arsye mobiliteti dhe lehtësie kanë bërë kërkesë zyrtare për të marrë shtetësinë e Shqipërisë. Me herën kanë qenë Ramush Haradinaj, Albin Kurti, e shumë të tjerë që kanë marrë pasaportën.

MARREVESHJA QEVERIA

Ministri i Jashtëm për marrëveshjen e “detit” me Greqinë: Nuk kalojmë “Vijën e kuqe”

Pakti, Bushati: Presidenti na kërkoj informacione shtesë

“Meta i informuar në çdo hap të negociatave”

Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati është i bindur në arritjen e një marrëveshjeje të drejtë për detin. Por ndërsa pala greke e quan të mbyllur tashmë çështjen shefi i diplomacisë shqiptare tregohet më i kujdesshëm e flet për vijim bisedimesh. Në intervistën për “Vizion Plus” Bushati thekson se pakti do të respektojë Kushtetutën. Ditmir Bushat tha se: “Besojmë se është një marrëveshje e drejtë për të dyja palët në respekt me të drejtën ndërkombëtare, por edhe me legjislacionin e brendshëm dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese”. Ministri i Jashtëm hedh poshtë çdo dyshim për komunikimin me Presidentin e Republikës për çështjen e marrëveshjes se detit. Ai konfirmon se kreu i shtetit është dijeni të çdo hapi sa i përket bisedimeve mes Tiranës e Athinës. “Ne jemi në kontakte me presidentin për çdo raund bisedimesh. Në disa raste ai ka kërkuar informacion shtesë që i është dhënë”, deklaroi z.Bushati. Por do të firmoset Dokumenti i partneritetit strategjik. Bushati nuk jep një datë fikse për këtë, por shprehet se fjalën e fundit do ta thonë kryeministrat Edi Rama dhe Aleksis Cipras. Marrëveshja për detin është në pikën e fundit të zgjidhjes. Kë të e njoftoi para pak ditësh në një intervistë në radion greke ministri i Jashtëm i Greqisë Nikos Kotzias, i cili foli edhe për debatin mbi ishullin e Othonit që ndodhet në ujërat mes dy vendeve. “Ekziston një negociatë e vjetër, ekziston dhe një vendim Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nevojiteshin përcaktime teknike dhe jemi në pikën e fundit të bisedimeve. Ne duam të kemi 100 përqind ndikim në ishujt që janë mbi Korfuz, sidomos në ishullin Othoni. Në marrëveshjen e vitit 2009, e morëm 100 përqind ndikim në ishullin e Othonit dhe Gjykata Kushtetuese në Shqipëri bëri një vërejtje për këtë fakt. Në vitin 1977 ish-qeveria e Karamanlisit i dha ndikim Greqisë vetëm në 70% ish-



Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati

ullit të Othonit. Këtu kishim një vështirësi të cilën besoj do ta tejkalojmë dhe do ta rregullojmë”, theksoi ministri grek. I pyetur për çështjen e shumë diskutueshme të zgjerimit të kufijve në 12 milje detare, Kotzias sqaroi: “12 milje nuk kanë lidhje me zonën ekskluzive ekonomike, është territori detar i Greqisë ku ajo duhet të ushtroje sovranitetin e saj. Prej shumë dekadash e kemi 6 milje, kështu do ta dyfishojmë atë në 12 milje. Dalëngadalë do ta vazhdojmë me Turqinë pasi ta kemi përfunduar me Shqipërinë, të shohim si do të shkojë”. Shefi i diplomacisë greke mohoi të jetë diskutuar për çështjen çame. Ai nënvizoi se ajo nuk është trajtuar asnjëherë në tryezën e bisedimeve. “Me Shqipërinë nuk kemi diskutuar kurrë për çështjen çame dhe nuk do ta diskutojmë kurrë në paketën e çështjeve. Të jemi të qartë për këtë. Çështja e pasurive të çamëve i përket mbarimit të luftës, për të cilat ka vendime gjykatë të paktyeshme. Behet fjalë për pasuri që u konfiskuan për bashkëpunim e komunitetit çam me armikun, me nazizmin, në Thesproti”,

tha z.Kotzias. Tirana dhe Athina zyrtare po punojnë për finalizimin e shpejtë të marrëveshjes, një dokument që pritet të firmoset nga kryeministrat Rama e Tsipras.

nuk kemi diskutuar kurrë për çështjen çame dhe nuk do ta diskutojmë kurrë në paketën e çështjeve. Të jemi të qartë për këtë. Çështja e pasurive të çamëve i përket mbarimit të luftës, për të cilat ka vendime gjykatë të paktyeshme. Behet fjalë për pasuri që u konfiskuan për bashkëpunim e komunitetit çam me armikun, me nazizmin, në Thesproti”,

tha z.Kotzias. Tirana dhe Athina zyrtare po punojnë për finalizimin e shpejtë të marrëveshjes, një dokument që pritet të firmoset nga kryeministrat Rama e Tsipras.

DEKLARATA

Ministri i Jashtëm hedh poshtë çdo dyshim për komunikimin me presidentin Meta për marrëveshjen e detit. Ai konfirmon se kreu i shtetit është dijeni të çdo hapi të bisedimeve mes Tiranës e Athinës. “Ne jemi në kontakte me presidentin për çdo raund bisedimesh. Në disa raste ai ka kërkuar informacion shtesë që i është dhënë”, tha Bushati.

Arta Marku nesër para vettingut me dy kolegë të saj



Arta Marku, Prokurorja e Përgjithshme dhe përkohshme do të dalë këtë javë para komisionit të vettingut për t'u verifikuar për pastërtinë e figurës së saj. Seanca dëgjimore për Markun do të mbahet më 3 korrik ora 10:00 tek Pallati i Kongresit. Trupa gjyqësore që do të vendosë për kryeprokuroren përbëhet nga Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko, Suela Zhegu. Po atë ditë, më 3 korrik, para vettingut, do të dalë dhe prokurori i Apelit i Tiranës, Luan Kaloçi. Seanca për të është paracaktuar në orën 13:00. Trupa Gjyqësore përbëhet nga Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari, Eteda Çiftja. Këtë javë në seancë dëgjimore do të paraqitet edhe gjyqtarja Alma Brati; më 4 korrik, ora 12:00 pm. Trupa gjyqësore përbëhet nga Pamela Qirko, Lulzim Hamitaj, Genta Tafa (Bungo).

Depolitizimi i komisioneve zgjedhore, Kume: Të nisë nga KQZ

Depolitizimi i komisionit të zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme, do të varet vetëm nga vullneti i partive politike, sepse koha për të bërë ndryshimet në Kodin Zgjedhor është më se e mjaftueshme, thotë ish-kryetari i KQZ-së Kristaq Kume. Rruga që duhet të ndiqet, sipas tij duhet të garantojë mbajtjen e durave të politikës larg vullnetit të zgjedhësve. “Realizohet nëse kanë vullnet



ta bëjnë”, tha z.Kume për “Tvklanj”. Por sipas Kumes, procesi duhet të nisë fillimisht nga Komisioni Qen-

SISTEMI

Pak kohë më parë, kreu i prezencës së OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchard foli për depolitizim të të gjithë sistemit të zgjedhjeve dhe vendosjen e tij në duart e ekspertëve.

dror i Zgjedhjeve. Ndonëse pohon se depolitizimi i administratës zgjedhore nuk e shmang tërësisht shitblerjen e votave, i bindur është që ky proces ndikon në minimizimin e këtij fenomeni shqetësues në raportet e OSBE-ODIHR-it. “Nuk është çelësi i artë, por e minimizon”, shprehet Kume. Pak kohë më parë, kreu i prezencës së OSBE-së në Tiranë, Bernd Borchard foli për depolitizim të të gjithë sistemit të zgjedhjeve dhe vendosjen e tij në duart e ekspertëve”.

Permbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankan pasurine :

a) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 52/21 , volumi 10 , Faze 248, ne zonen kadastrale nr 1100 , me siperfaqe totale 3230 m2 , e ndodhur ne adresen Barbulush Shkoder
b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 52/21 , volumi 9 , Faze 3, ne zonen kadastrale nr 1100 , me siperfaqe totale 2360 m2 , e ndodhur ne adresen Barbulush Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Arkand për pasuritë e sipërpërmëtuara , është në vlerën Për pasuritë “Toka Are” me sip 3230 m2 , është në vlerën 488,376 leke
Për pasuritë “Toka Are” me sip 2360 m2 , është në vlerën 356,832 leke
Shitja e pasurisë fillohet me datë 04.07.2018 ora 16:15 ne Zyren e permbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

Shitje me Ankan te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

“Truall + ndertese”, me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me siperfaqe totale trualli 1.837 m2 dhe siperfaqe ndertese 260.6 m2 me adresë Ishati Shtoi i Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emat te Zako Spaso Ajković. Çmimi fillistar per shitje është 22.400.000 Leke.

Data e shpalljes 21.06.2018
Data e zhvillimit 13.07.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adresë Rruga “Mystym Shyri” Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Ministri i Punës, Heil: Do të rriten pagesat

Gjermania kërkon 50 mijë punonjës për shëndetësinë, viza dhe për shqiptarët

Ministri gjerman i Shëndetësisë Jens Spahn do të kërkojë ndihmë në Evropën Juglindore për zgjidhjen e problemit me mungesën e personelit në shëndetësi. Në veçanti në Kosovë dhe Shqipëri ka një potencial shumë të lartë të fuqisë së re punëtore, deklaroi ai për gazetën gjermane "Bild am Sonntag". "Përgatitja e personelit atje është shpesh më e mirë se

sa mendojmë ne", tha Spahn. "Por ka shumë probleme të mëdha me dhënien e vizave". Politikani i CDU-së thotë: "Ajo që nuk mund të kuptoj fare është se këta persona të përgatitur dhe të shkolluar duhet të presin shpesh deri në dhjetë muaj për një vizë për Gjermani. Këto procedura duhet të përshtrohen". Edhe njohja e diplomave zgjat tepër gjatë, mendon ministri. Spahn pohon se Gjermania ka nevojë

për rreth 50.000 persona që punojnë në shëndetësi dhe sektorin e përkujdesjes për të moshuarit. "Duhet të kërkojmë ndihmë në vendet jashtë Gjermanisë". Në Gjermani nuk ka më gati asnjë spital apo institucion për përkujdesjen që të mos ketë fuqi punëtore nga vendet tjera. Ministri i Punës Hubertus Heil (SPD) planifikon të fusë të drejtën që të huajt të marrin vizë për gjashtë muaj



me qëllim që të kërkojnë punë në Gjermani. "Të huajt që duan të punojnë në sektorin e përkujdesjes do të duhet të marrin vizë për gjashtë muaj dhe të vijnë në Gjermani. Kushti: ata nuk mund të marrin asnjë cent nga sistemet sociale, e nëse as pas gjashtë

muajve nuk kanë gjetur ndonjë vend pune, atëherë duhet të kthehen në vendin e tyre", tha Heil për të njëjtën gazetë. Me rëndësi është që Gjermania më në fund të nxjerrë një ligj të mirë për ardhjen e organizuar të migrantëve. Spahn ka bërë të ditur para disa

ditësh se ai, ministri Heil dhe ministrja e Familjes Franziska Giffey (SPD) do të nisnin një "Aksion të koncentruar për përkujdesjen". Partitë e Unionit dhe socialdemokratët kanë rënë dakord në programin e tyre qeverisës që të përmirësojnë kushtet për përgatitjen profesionale, informimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në këtë sektor. Heil ka bërë të ditur se rrogat për personat që punojnë në fushën e kujdesit për të moshuarit të rriten dukshëm deri në mes të vitit të ardhshëm. Të tre ministrat kanë dhënë së bashku intervistë për gazetën "Bild am Sonntag".DW.

Intervista/ Plagosja e trefishtë në Kinostudio, flet Gjyzepeina mamaja e vëllezërve Mumajesi

Ina Allkanjari

Disa ditë pas përplasjes me armë zjarri në zonën e Kinostudios në kryeqytet, ku mbetën të plagosur Rivelino e Juxhin Mumajesi dhe 28-vjeçari Ibrahim Durollari flet në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" mamaja e dy vëllezërve, Gjyzepeina Mumajesi. Ndërsa mësohet se gjendja shëndetësore e të rinjve është përmirësuar e të ëma e tyre tregon se djali i saj Juxhini prej vitesh ka jetuar në Francë dhe kishte vetëm një javë që kishte ardhur në Shqipëri. "Djali im Juxhini ka 10 vite që jeton në Francë. Rreth moshës 15 vjeçare është larguar nga Shqipëria dhe është me dokumente franceze. Në Shqipëri u kthye një javë përpara se të ndodhte ngjarja në Kinostudio. Djali nuk ka asnjë precedent penal, ai prej vitesh nuk jeton në Shqipëri dhe nuk ka qenë i përfshirë në asnjë ngjarje në këtë vend", u shpreh mamaja e dy vëllezërve Mumajesi për "GSH". Kujtojmë se mesnatën e 27 qershorit në rrugën "Aleksandër Moisiu", në një lokal bastesh kanë mbetur të plagosur me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar, shtetasit Juxhin Mumajesi 24 vjeç, Rivelino Mumajesi 36 vjeç dhe Ibrahim Durollari 28 vjeç. Ka dyshime se 2 persona ende të pa identifikuar nga policia, iu afruan personave që mbetën të plagosur dhe hapën zjarr ndaj tyre. Ndërsa policia vijon hetimet për zbardhjen e plotë të sulmit, ngjarja mbetet ende pa autor.

Disa ditë më parë dy djemtë tuaj Juxhini dhe Rivelino mbetën të plagosur në zonën e Kinostudios. Mësohet se një ndër pistat që po heton policia është një konflikt i Rivelinos i ndodhur një vit më parë. Mendoni se ajo ngjarje ka lidhje me sulmin e 27 qershorit?

Nuk di asgjë për këtë pjesë. Nuk kam asnjë informacion për shkakun e sul-



Vendi ku ndodhi ngjarja

VËLLEZËRIT MUMAJESI

Juxhini jeton dhe punon në Francë, punon në një magazinë fruta perime. Ai është i martuar në Francë dhe ka një fëmijë 1 vjeç. Nusja dhe krushqit u shqetësuan shumë kur morën vesh lajmin, kjo pasi Juxhini asnjëherë nuk është përfshirë në asnjë konflikt, ka vetëm një javë në Shqipëri. Rivelino nuk ka pasur probleme më herët përveç ngjarjes së ndodhur një vit më parë.

mit.

U përfol se djemtë kanë ndërnuar mbiemrin për shkak të së shkuarës, çfarë mund të na thoni lidhur me këtë gjë?

Juxhini jeton prej vitesh në Francë. Largimi i tij nga vendi dhe marrja e nënsh-tetësisë franceze është shkak i ndryshimit të mbiemrit në Hamajezi. Ai nuk e

ndërron dot mbiemrin në Mumajesi siç është në rrënjën e familjes pasi është me dokumente franceze. Vetëm Juxhini e ka ndryshuar mbiemrin për këtë arsye.

Prej sa vitesh jeton në Francë Juxhini dhe cila ishte arsyeja e kthimit në Shqipëri?

Djali im Juxhini ka 10 vite që jeton në Francë.

ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI

Përmbarese gjyqesore private Enirjeta Zisi zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Apartamenti" me sipërfaqe 92.1m², ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7,Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, të ndodhur në Tiranë, Yzberisht pranë rruges "Joklin Pensi", kati 1,3, shk.1 ap.7 Tiranë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit Yzeir Llanaj.

Çmimi i ri më të cilin shpallat ankandi është në shumën 3.010.392 (tre mijon e dhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

Ankandi zhvillohet në datë 04.07.2018, ora 16.00 në zyrën e Përmbarese gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora" Kulla 2, Kati 1, Tiranë Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com

Rreth moshës 15 vjeçare është larguar nga Shqipëria dhe është me dokumente franceze. Në Shqipëri u kthye një javë përpara se të ndodhte ngjarja në kinostudio. Ai erdhi pasi kishim një rast ditëlindjeje në familje. Djali e ka prerë biletën vajtje ardhje dhe në datë 15 korrik nisjet për Francë.

Pra, ai nuk ka asnjë konflikt të hapur në Shqipëri, po Rivelino?

Juxhini nuk ka asnjë precedent penal, ai prej vitesh nuk jeton në Shqipëri dhe nuk ka qenë i përfshirë në asnjë ngjarje në këtë vend. Ai jeton dhe punon në Francë,

punon në një magazinë fruta perime. Juxhini është i martuar në Francë dhe ka një fëmijë 1 vjeç. Nusja dhe krushqit u shqetësuan shumë kur morën vesh lajmin, kjo pasi Juxhini asnjëherë nuk është përfshirë në asnjë konflikt, ka vetëm një javë në Shqipëri. Rivelino nuk ka pasur probleme më herët përveç ngjarjes së ndodhur një vit më parë.

Si është gjendja shëndetësore e djemve?

Gjendja shëndetësore e djemve është shumë më mirë, nuk kanë qenë në gjendje të rëndë. Tashmë janë shumë mirë.

NGJARJA

Mesnatën e 27 qershorit në rrugën "Aleksandër Moisiu", në një lokal bastesh kanë mbetur të plagosur me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar, shtetasit Juxhin Mumajesi 24 vjeç, Rivelino Mumajesi 36 vjeç dhe Ibrahim Durollari 28 vjeç. Ka dyshime se 2 persona ende të pa identifikuar nga policia, iu afruan personave që mbetën të plagosur dhe hapën zjarr ndaj tyre.

EPSPA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

1- "Pyll + Kullote" me sip. 280.000 m², Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **4.800.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

2- "Pyll + Kullote" me sip. 95.000 m², Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1.628.680 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

3- "Truall + Ndërtim" me sip.3.250 m² nga kjo 1474,5 m² ndërtesë me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **545.440 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

4- Për pasurinë me Nr.578/184, vol.13, fq.216, Zk.3385, me sip.1.270 m² me adresë Shkallnur, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **35.560 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

5-Për pasurinë me Nr.1/973+1-9, vol.41, fq.85, Zk.8513, me sip.119,2 me adresë Rr."Muco/15", Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **40.400 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

6-Për pasurinë me Nr.160/51, vol.16, fq.72, Zk.2574, me sip.2.470 m² me adresë Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **138.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

7- Për pasurinë me Nr.160/50, vol.6, fq.71, Zk.2574, truall + ndërtesa me sip.7.330 m² me adrese Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **941.360 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratarri", K.6,Tiranë.

Për cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

Në kërkim pronari italian. Dy personat akuzohen se kanë trafikuar armë dhe municione

Tritol në një kompani plastikash, arrestohet menaxheri, Agron Kryeziu

Sekuestrohen 4 pako të mbështjella me lëndë plasëse

DURRES

Policia ka vënë në pranga ditën e djeshme menaxherin një kompanie private në Durrës dhe ka shpallur në kërkim pronarin pasi akuzohen se kanë trafikuar armë dhe municione. Konkretisht është arrestuar në flagrancë shtetasi Agron Kryeziu, 28 vjeç, banues në Durrës. Ndërkohë po punohet për kapjen e pronarit të kompanisë, shtetasi italian E.B., 43 vjeç. Kjo pasi gjatë kontrollit në ambientet e kompanisë, e cila merret me prodhimin e profileve plastike, uniformat blu kanë sekuestruar disa pako të dyshuara me lëndë plasëse tritol dhe kapsolla të montuara. Dy shtetasit e mësipërm do të përballen me akuzat "Trafikimi i armëve dhe i municionit", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Punësimi i paligjshëm".

NGJARJA

Specialistët kundër Trafiqeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative, kanë goditur një rast trafikimi të armëve dhe municioneve. Gjatë operacionit policor janë sekuestruar pako të dyshuara me lëndë tritol. Gjatë kontrollit të ushtruar në kompaninë private, e cila merret me prodhimin e profileve plastike, në një kovë plastike me bojë kanë gjetur dhe sekuestruar 4 pako të mbështjella me lëndë plasëse të dyshuar



Foto ilustruese

KONTROLLI

Gjatë kontrollit të ushtruar në kompaninë private, e cila merret me prodhimin e profileve plastike, në një kovë plastike me bojë kanë gjetur dhe sekuestruar 4 pako të mbështjella me lëndë plasëse të dyshuar tritol, ku secila pako ishte e lidhur me dy fije teli të veshura dhe me kapsolla të montuara.

ARRESTIMI

Policia e Durrësit ka arrestuar në flagrancë menaxherin e firmës, shtetasin Agron Kryeziu, 28 vjeç, banues në Durrës. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e pronarit të kompanisë, shtetasi italian E.B. 43 vjeç.

tritol, ku secila pako ishte e lidhur me dy fije teli të veshura dhe me kapsolla të

montuara. Në bazë të këtij operacioni u bë i mundur arrestimi në flagrancë i

menaxherit të firmës, shtetasit Agron Kryeziu, 28 vjeç, banues në Durrës. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e pronarit të kompanisë, shtetasi italian E.B. 43 vjeç. Ndërkohë po punohet për sqarimin e rrethanave të tjera të veprës penale dhe personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit", "Fshehja e të ardhurave", "Punësimi i paligjshëm".

SHKURT

Kërcënon me vdekje të riun në Elbasan, në kërkim 25-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka ndaluar në kohë një konflikt me armë zjarri. Shërbimet e Policisë Elbasan, kanë marrë njoftim se në lagjen "Shënkoll", Elbasan, ka një konflikt mes dy të rinjve, ku njëri prej tyre dyshohet se ka dhe armë zjarri. Menjëherë shërbimet e policisë kanë shkuar në vendngjarje, ku shtetasi Enea Verushi, sapo ka parë policinë ka hedhur armën e zjarrit dhe është larguar me shpejtësi. Nga veprimet e kryera nga grupi hetimor ka rezultuar se shtetasi Enea Verushi, 25 vjeç, banues në lagjen "Brigada 17 Sulmuesi", Elbasan, pas një konflikti për motive të dobëta ka kanosur me armë zjarri, shtetasin A.Sh., 32 vjeç, banues, në Elbasan. Vijon puna për kapjen e shtetasit të shpallur në kërkim. Në cilësimin e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit tip "Pushkë", dhe 7 fishekë. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprime të mëtejshme për veprat penale "Kanosja" "Prishja e qetësisë publike", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të zjarrit".

Abuzonte seksualisht me gruan, arrestohet shqiptari në Itali

ITALI - Një shqiptar 39 vjeç ka rënë në prangat e policisë italiane pasi akuzohet për abuzim seksual në familje. Ngjarja ka ndodhur në provincën e Salerno, dhe ndaj shqiptarit rëndon akuzat e abuzimit ndaj anëtarëve të familjes, sulm seksual të rënduar, etj. Hetimet ndaj shqiptarit, nisën pas ankesave të partneres së tij 24 vjeçare. Përveç rrahjes dhe poshtëritimit, ai e ka detyruar atë të kryej marrëdhënie intime përpara fëmijës së tyre 3 vjeçare, me të vetmin qëllim për t'i treguar atij se si kryhet akti seksual. Ngacimimet seksuale kanë vazhduar të paktën nga viti 2014, pas kësaj vitesh, ajo ka gjetur guxim për të raportuar partnerin e saj, duke e çuar prapa hekurave, siç shkruan "Ilgiornale". Tashmë, burri ndodhet në burgun Fuorni, ndërsa gruaja dhe djali i saj janë strehuar nga autoritetet.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2.457.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 31 Korrik 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA
TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for Bid 1: Equipment for data centre and network, and installation in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.

The tender dossier is available at <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>; from June 18, 2018. The deadline for submission of tenders is: July 18, 2018, time 10:00 hrs, at Institute of Statistics of Albania, Biv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tirana, Albania.

Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>. Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to 14 days before the date of submission of offers.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
NJOFTIM TENDERI

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: Bid 1: "Pajisje për server dhe rrjetin, dhe instalim".

Dokumentet e tenderit mund të gjeni në adresën: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>, nga Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: 18.07.2018, ora 10:00, në adresën: Instituti i Statistikave, Biv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë.

Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>. Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në 14 ditë para ditës së fundit për dorëzimin e ofertave.

PENSIONET SUPLEMENTARE MASA E PAGESËS

Voltiza Duro

Jo në pak raste, pensio ni i pleqërisë është i pamjaftueshëm për disa kategori të moshuarish, por ata mund të përfitojnë një pagesë shtesë nëpërmjet pensionit suplementar. Sipas skemës së këtij të fundit, është caktuar që masa e kontributeve suplementare të jetë 3.5 për qind të pagës bruto mujore për personat e punësuar në institucione publike dhe 7 për qind të pagës bruto mujore, për personat që punojnë në institucione jopublike, të cilat derdhen në llogaritë e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore çdo muaj, me të njëjtat rregulla dhe në të njëjtat afate, si edhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror. "Gazeta Shqiptare" publikon sot mënyrën e përlogaritjes së pensioneve suplementare duke e konkretizuar me shembuj. Ndërkohë, ISSH bën me dije se punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga bruto e punëmarrësve kontributin e përcaktuar për këta persona dhe ta derdhë atë në llogarinë e fondit të përfitimeve shtetërore suplementare. Punëdhënësi detyrohet të paraqesë brenda datës 30 të muajit pasardhës listë-pagesën e personave që përfitojnë, pagën bruto dhe shumën e kontributeve të ndaluara.

PËRLOGARITJA

Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se formula e re e pensioneve është në favor të atyre kategorive që kanë periudha më të gjata kontributive dhe derdhin kontribute mbi paga më të larta. Pavarësisht kësaj, formula ka rruajtur kufirin minimal dhe ka si qëllim t'i kthejë çdo personi atë që i takon. Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës: $PSP = PMRMN \times VSH \times 1\%$ ku PSP nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; ndërsa VSH janë vitet e Shërbimit. Por masa që rezulton nga kjo formulë nuk duhet të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë. Nëse një ushtarak përfiton pension pleqërie sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, dhe masën

Kategoritë e të moshuarve që mund të marrin më shumë para. Kushtet që duhet të plotësojnë

Si të përlogarisni pensionet suplementare të pleqërisë

ISSH sjell shembujt konkretë, formula e saktë



KATEGORITË PËRFITUESE DHE FORMULA E LLOGARITJES

Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim suplementar kanë të drejtë të marrin:

- ◆ Ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë;
- ◆ Punonjësit e Policisë së Shtetit;
- ◆ Punonjësit e Gardës së Republikës,
- ◆ Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit
- ◆ Punonjësit e Policisë së Burgjeve
- ◆ Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit,
- ◆ Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm
- ◆ Punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Sipas ligjit, ka disa lloj përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për:

- ◆ pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
 - ◆ pensionin suplementar të pleqërisë;
 - ◆ pensionin suplementar të invaliditetit;
 - ◆ pensionin familjar.
- Llogaritja e një pensioni suplementar të pleqërisë bëhet sipas formulës:
 $PSP = PMRMN \times VSH \times 1\%$
 PSP nënkupton pensionin Suplementar të Pleqërisë; PMRMN është Paga Mesatare Referuese Mujore Neto; VSH janë vitet e Shërbimit.

3.5%

MASA E KONTRIBUTEVE SUPLEMENTARE

Sipas skemës së këtij të fundit, është caktuar që masa e kontributeve suplementare të jetë 3.5 për qind të pagës bruto mujore për personat e punësuar në institucione publike dhe 7 për qind të pagës bruto mujore, për personat që punojnë në institucione jopublike.

50%

E MASËS SË PENSIONIT TË PLEQËRISË

Por, pensioni suplementar i pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që ushtaraku gëzon, në çastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar.

50% e pensionit të pleqërisë, pra 13,000 lekë / muaj. Pra, ish ushtaraku do të përfitojë pension suplementar pleqërie në masën 13,000 lekë/muaj.

USHTARAKËT NË LIRIM

Edhe ushtarakët që kanë punuar në një prej institucioneve të përcaktuara me ligj kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfitim suplementar kanë të drejtë të marrin të gjithë Ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë; punonjësit e Policisë së Shtetit; ata të Gardës së Republikës, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit si dhe ata të Policisë së Burgjeve. Gjithashtu, nga pensioni suplementar mund të përfitojnë edhe punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Sipas ligjit, ka

26,000 lekë në muaj; ai ka 28 vite shërbimi si ushtarak dhe pagë mesatare referuese mujore neto 53,700 lekë në muaj. Llogaritja e pensionit suplementar të pleqërisë bëhet në këtë mënyrë: $PSP = 53,700 \text{ lekë} \times 28 \text{ vite} \times 1\% = 15,036 \text{ lekë} / \text{muaj}$. Por, pensioni suplementar i

pleqërisë nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e pensionit të pleqërisë që ushtaraku gëzon, në çastin e lindjes së të drejtës së pensionit suplementar. Kështu ushtaraku përfiton pension pleqërie në masën 26,000 lekë/muaj. Në këtë rast, pensioni suplementar i pleqërisë është sa

disa lloj përfitimesh që administrohen nga ISSH-ja, e respektivisht bëhet fjalë për: pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi; pensionin suplementar të pleqërisë; pensionin suplementar të invaliditetit; si dhe për atë familjar. Kështu për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, burrat duhet të kenë mbushur moshën 47 vjeç e të kenë jo më pak se 15 vite pune, ndërsa gratë duhet të jenë mbi 42 vjeç e të kenë jo më pak se 12 vite shërbimi. Ndërkohë mund të përfitojnë pension suplementar pleqërie të gjitha kategoritë e sipërmendura, dhe pension su-

plementar invaliditeti po këto kategori që janë deklaruar invalidë dhe përfitojnë pension invaliditeti të plotë apo të pjesshëm, sipas Ligjit nr. 4171, "Për sigurimet shoqërore të RPSH" dhe Ligjit nr. 7703, "Për sigurimet shoqërore në RSH". Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se kur personat e familjes në ngarkim të personave të sipërpërmendur dhe familjet e ushtarakëve që humbasin jetën në krye të detyrës e përfitojnë pension familjar, sipas Ligjit kanë gjithashtu të drejtën e marrjes së pensionit suplementar familjar.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbareus gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
 Datë 04/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00, përfundon ankandë i ri (1 parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:
 "Apartament" me sipërfaqe prej 82 m², e ndodhur në Korçë, në vlerën 2,099,200 lekë.
 Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontratës për venien e sendit në hipoteke të debitorit Z.Bashkim Imit Selaj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit Z.Alfred Selim Xhambazi banues në Korçë
 Ankandet zhvillohet pranë zyrës së përmbareusit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 «1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail: simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbareus gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
 Datë 03/07/2018, ditën e Martë, ora 16:00, përfundon ankandë i ri (1 parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:
 "Apartament" me sipërfaqe prej 53.92 m², Rr."Ahmet Bektashi", plli.59.shk.1.k2.ap.6, në Kolonjë, në vlerën 1,600,000 lekë.
 Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontratës për venien e sendit në hipoteke të debitorit znj.Donika Thoma Pira, Erseke, Kolonjë, për detyrimin ndaj kreditorit z.Ylli Koco Sotiri, banues në Erseke, Kolonjë.
 Ankandet zhvillohet pranë zyrës së përmbareusit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 «1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail: simaartan@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Zyra përmbareusit "Best2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 16 korrik 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbareusit do zhvillohet ankandë për shitjen e pasurisë nr.58/55, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8516, Plazh, Durrës. Truallë që ka sipërfaqen prej 630 m² kutkozhet sipas një marrëveshjeje sipërmarrjeje.
 Prona është e vëllëzëve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta
 Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandë do të jetë 570000 Euro.
 Çmimi mund të llogaritet edhe në lek sipas kursit të këmbimit ditor.
 Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbareusit 10% të çmimit fillestar.
 Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
 E-mail: best.2010@permbareus.al, web: www.permbareus.al

Shefi i hetimit: Janë ndërmarrë 140 aksione gjatë vitit të kaluar

Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë, pre vajzat e të miturit

DASH: Numri më i madh i viktimave seksuale përbëhet nga femrat

Grupet e ndryshme kriminale janë mjaft aktive në shfrytëzimin e kategorive të caktuara, kryesisht femrave dhe të miturve, për trafikim me qenie njerëzore. Trafikantët, viktimat e tyre i shfrytëzojnë kryesisht për përfitime apo me qëllim të shfrytëzimit seksual, përkatësisht shfrytëzimit për prostitucion. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit bën të ditur se gjatë vitit 2017 institucionet e Kosovës kanë identifikuar 32 viktima të trafikimit, përkatësisht 25 gra dhe tre meshkuj. Prej tyre, 18 viktima kanë qenë subjekt i trafikimit për shfrytëzim seksual, shtatë kanë kryer punë të detyrueshme, tre prej tyre kanë kërkuar lëmshë, derisa katër të tjerë janë cilësuar si "të nënshtruar plotësisht". Numri më i madh i viktimave seksuale përbëhet nga vajzat që vijnë nga Kosova, Shqipëria, Moldavia, Rumania, Serbia dhe Filipinet. Institucionet e Kosovës thonë se kanë ndërmarrë aksione të shumta për të parandaluar trafikimin me qenie njerëzore. Shef i sektorit qendror të hetimit të trafikimit me qenie njerëzore, Riza Murati, thotë për Radio Evropë dhe Lirë se policia e Kosovës ka ndërmarrë mbi 140 aksione gjatë vitit të kaluar në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Sipas tij, numri më i madh i viktimave të trafikimit kanë qenë subjekt i trafikimit seksual. "Ne tani viktimat i kemi më tepër ato që janë vendore sesa që vijnë nga vendet e tjera. Prej 32 viktimave sa kanë qenë vitin e kaluar, ne kemi identifikuar se diku shtatë prej tyre kanë qenë nga vendet e tjera, pesë nga Shqipëria, një nga Moldavia dhe një nga Filipinet, domethënë janë identifikuar si viktima të trafikimit të shfrytëzuar në Kosovë", tha Murati. Një prej vendeve ku ka rezultuar me gjetjen e viktimave që ishin subjekt i trafikimit për shfrytëzim sek-



RIZA MURATI:

"Ne tani viktimat i kemi më tepër ato që janë vendore sesa që vijnë nga vendet e tjera. Prej 32 viktimave sa kanë qenë vitin e kaluar, ne kemi identifikuar se diku shtatë prej tyre kanë qenë nga vendet e tjera, pesë nga Shqipëria, një nga Moldavia dhe një nga Filipinet, domethënë janë identifikuar si viktima të trafikimit të shfrytëzuar në Kosovë", tha Murati.

sual kanë qenë qendrat e ndryshme të masazheve. "Këtë vit kemi zhvilluar një operacion kontrolli nëpër sal-

lonet e masazhës apo lokale e tilla dhe ka rezultuar se nga 68 sosh, sa janë kontrolluar, 40 prej tyre janë mbyllur", dek-

BEHXHET SHALA:

"Nuk i marrin dënimet e merituar, dënimet janë të ulëta dhe shpejt dalin nga burgu. Institucionet jo pse nuk bëjnë diçka, mirëpo është e pamundur me këtë kapacitet profesional që kanë dhe mundësitë t'i mbulojnë të gjitha rastet. Raporti është objektiv. Numri nuk është real, sepse ka shumë më tepër raste të trafikuar, por nuk ka kapacitet më shumë për të bërë më tepër", tha Shala.

RAPORTI I DASH PËR 2017:

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit bën të ditur se gjatë vitit 2017 institucionet e Kosovës kanë identifikuar 32 viktima të trafikimit, përkatësisht 25 gra dhe tre meshkuj. Prej tyre, 18 viktima kanë qenë subjekt i trafikimit për shfrytëzim seksual, shtatë kanë kryer punë të detyrueshme, tre prej tyre kanë kërkuar lëmshë, derisa katër të tjerë janë cilësuar si "të nënshtruar plotësisht". Numri më i madh i viktimave seksuale përbëhet nga vajzat që vijnë nga Kosova, Shqipëria, Moldavia, Rumania, Serbia dhe Filipinet.

diçka, mirëpo është e pamundur me këtë kapacitet profesional që kanë dhe mundësitë t'i mbulojnë të gjitha rastet. Raporti është objektiv. Numri nuk është real sepse ka shumë më tepër raste të trafikuar, por nuk ka kapacitet më shumë për të bërë më tepër", tha Shala.

lari Murati. Gjendja ekonomike në Kosovë është shumë favorizuese për trafikantët, thotë Behxhet Shala nga Këshilli për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Shala thotë për Radio Evropë dhe Lirë se luftimi i trafikimit është i vështirë, pasi që institucionet nuk i kanë kapacitetet e nevojshme profesionale. "Nuk i marrin dënimet e merituar, dënimet janë të ulëta dhe shpejt dalin nga burgu. Institucionet jo pse nuk bëjnë

SHKURT

Dje Dita Ndërkombëtare e KFOR-it në Kosovë

Dita Ndërkombëtare e KFOR-it u mbajti në Kampin "Kosova Film", dhe kishte për qëllim të promovonte kulturën e KFOR-it për stafin civil vendor dhe ndërkombëtar dhe për familjarët e tyre. Kjo ngjarje organizohet çdo vit nga KFOR-i dhe 28 vendet anëtare të tij, që përfaqësojnë një përzjerje të kulturave dhe etnive, të cilat bashkëjetojnë dhe vepronë të bashkuara për të gjithë qytetarët në Kosovë. Aktivitete dhe kuzhina të ndryshme nga 28 vende u përgatitën për mysafirët, të cilat treguan mikpritjen dhe kulturën e secilit komb që kontribuon në KFOR. Ekipi akrobatik i njësive italiane të parashutistëve u lëshua me parashutë atë pasdite.

SHBA, valë protestash anti-Trump

Rreth 600 manifestime u zhvilluan në Shtetet e Bashkuara brenda një dite, kundër politikës së Presidentit Trump për ndarjen e familjeve të emigrantëve të jashtëligjshëm. Protesta pati nga Nju Jorku, me mbi 30 mijë manifestues që marshuan në urën e Bruklinit, në Uashington, Los Anxheles, Boston e qindra qytete të tjera. Manifestuesit kërkuan shpërbërjen e Agjencisë Ligjzbatuese për Doganat dhe Migracionin, që zbatoi në terren urdhrin e Trump për ndarjen e fëmijëve nga prindërit e tyre emigrantë që kalojnë ilegalisht kufirin amerikan. Zërit të manifestuesve në Uashington iu bashkuan edhe figura si këngëtarja Alicia Keys dhe aktorja America Ferrera. Duke akuzuar Presidentin Trump si fashist, manifestuesit zgjodhën si simbol të manifestimeve grushtin lart. Në reagimin e tij në Twitter, Trump mbrojti agjencinë që është pjesë e Departamentit për Sigurinë dhe akuzoi protestuesit si radikalë të majtë brenda radhëve të demokratëve. Urdhri i dhënë nga Trump në prill dhe që qëndroi në fuqi për 2 muaj ndau mbi 2300 fëmijë nga prindërit e tyre emigrantë, duke u shkakuar atyre trauma sociale.

Konflikti me Kosovën, Jovanović: Bota mban tjetër qëndrim nga ne

Kryetari Partisë LDP: Duhet të flasim me shqiptarët, është e vështirë për Serbinë

Kryetari Partisë Liberale Demokratike (LDP) në Serbi, Çedomir Jovanović, vazhdon të insistojë se Serbia duhet ta pranojë realitetin lidhur me Kosovën dhe se kjo çështje është nja më e madhe, të cilën, siç thotë ai, duhet ta zgjidh ky brez. "Mendoj se është shumë e vështirë që të pranohet realiteti në Serbi. Përpjekjet për balancimin dhe flirtim me politikën, që na solli në këtë fazë, të cilën ne e quajmë realiteti në Kosovë, gjithnjë e më shumë janë në një rrugë pa krye", tha Jovanović për gazetën

malazeze "Pobjeda". Siç shkruan gazeta serbe "Blic", udhëheqësi i LDP ka thënë se e tërë bota ka një pozicion për Kosovën që është e ndryshme nga ai i Serbisë, "madje edhe rusët, për të cilët ne lidhemi, kanë mbështetur shumë veprime të bashkësisë ndërkombëtare, të cilat çuan në formimin e shtetit të Kosovës". "Nuk mund të them se kjo është nja më e madhe dhe se këtë nje gjenerata jonë duhet ta zgjidhë. Nëse fëmijëve tanë ua lëmë një të kaluar të tillë, për nipërit tanë nuk do të jemi kurrfarë pike e ndritshme. Paqe dhe

vetëm paqe", tha Jovanović, përcjell "Telegraf". Sipas tij, çështja e Kosovës ky nuk është problem i qeverisë, "ky është problem i kësaj shoqërie, i cili nuk guxon të ndahet me opozitës dhe pushtetit. "Pushteti, natyrisht, ka përgjegjësinë më të madhe, por do të duhet të ketë fuqinë për t'u marrë me këto çështje. Opozita jonë, në lidhje me Kosovën, ka qëndrime nacionaliste, do të thosha unë, qëndrime të vjetra". Nuk ka asnjë qasje e re, por nga lahuta është kaluar në muzikë ashensorësh",-tha ai. "Kur flasim për presio-



nin e Perëndimit, nuk duhet t'i harrojmë interesat e tyre. Ata shpesh nuk përputhen me idenë tonë se çfarë është Perëndimi. Perëndimi i ka problemet e veta dhe nuk dëshiron që ne t'i pengojmë në rrugën e përgjithshme të tyre", tha Jovanović. Lideri i LDP-së thotë se "ne duhet të shohim se si dhe se për çfarë do të flasim me shqiptarët,

kurse biseda është gjithmonë e mundur". "Pra, dialogu nuk duhet të ndalet dhe është e rëndësishme që të dy shoqëritë tona ta kuptojnë. Pavarësisht nga pasojat momentale. Kjo qasje është treguar e mirë si afatgjatë. Është e rëndësishme për një rajon të sigurt, paqësor dhe ekonomikisht prosperues",-përfundoi ai Jovanović

Drejtori Skënder Brataj: Telefononi 127, ne do t'ju orientojmë ku të drejtoheni

Urgjencat kirurgjikale, një herë në javë te Sanatoriumi

Rastet që nuk do të shkojnë te Shefqet Ndroqi

Voltiza Duro

Përfundimisht prej datës 4 korrik të këtij muaji, çdo të mërkurë urgjencat kirurgjikale do të përballohen nga Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", për të ulur kështu sadopak fluksin në QSUT. Në këtë mënyrë, është bërë riorganizimi i shërbimit të urgjencës mjekësore ku një herë në javë pacientët do t'i drejtohen Sanatoriumit, duke telefonuar fillimisht numrin 127. Aktualisht janë marrë të gjitha masat paraprake përpara operacionit, praninë e të gjithë specialistëve si kirurg, anesteziat, instrumentist dhe staf mbështetës. Në deklaratën e dhënë për mediat, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



bën me dije se ky lloj organizimi është i domosdoshëm veçanërisht për shpërndarjen e ngarkesës së punës në të gjitha spitalet universitare dhe për ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për pacientët. Ndërkaq, Skënder Brataj, drejtori i Urgjencës Kombëtare (institucion që do të menaxhojë riorganizimin e urgjencave) i bëri thirrje qytetarëve t'i drejtohen Urgjencës Kombëtare për çdo shërbim urgjence, duke telefonuar 127. "Ne jemi në gadishmëri për riorganizimin e shërbimit të urgjencës por ju bëjmë thirrje qytetarëve t'i drejtohen shërbimit të urgjencës, shërbim që di saktësisht ku du-

het të merrni shërbimin sipas rastit", theksoi Brataj.

PËRJASHTIMET

Përveç rasteve të urgjencës së Tiranës 1, të gjitha rastet që transferohen nga spitalet rajonale si të sëmurë kirurgjikale do të jenë me epikrizë përcjellese të vlerësuar nga ekipet në këto spitalet. Vlen të thekso-

RASTET E PËRJASHTUARA

Nuk do të referohen në Urgjencën Kirurgjikale në Sanatorium rastet e sjella me helikopter, rastet që i përkasin Dëgjje plastike, Obstetrikë-gjinekologjisë dhe Traumës



het se nuk do të referohen në Urgjencën Kirurgjikale në Sanatorium rastet e sjella me helikopter (sepse nuk ka pikë dislokimi). Gjithashtu edhe rastet që i përkasin dëgjje plastike, Obstetrikë-gjinekologjisë dhe Traumës nuk do të dërgohen te urgjencat kirurgjikale e Spitalit Universitar Shefqet Ndroqi. Ndërkohë roli i Qendrës Kombëtare të Urgjencës do të jetë shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimit. Çdo urgjencë kirurgjikale që do të vijë nga spitalet e rrethëve apo të Tiranës do të orientohet drejt Sanatoriumit. "Ftojme qytetarët të

telefonojnë 127 për çdo urgjencë mjekësore. Dhe rikujtojmë se çdo të mërkurë - urgjencat kirurgjikale do të mbulohet nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi", theksohet në deklaratën e Ministrisë së Shëndetësisë. Analiza dhe trendi i viteve të fundit ka qënë në rritje të vazhdueshme në Urgjencën Kirurgjikale në QSUT, e cila aktualisht ka një mesatare rreth 180 pacientë në ditë dhe kryhen rreth 10 ndërhyrje urgjente në ditë. Riorganizimi i urgjencave mjekësore është bërë për të mundësuar uljen e dyndjes së të sëmurëve drejt QSUT-së.

Hapet dega më e re Fibank Albania në Lezhë

Dega Lezhe është me e reja e hapur nga Fibank si pjesë e strategjisë së zgjerimit dhe rritjes të biznesit në Shqipëri. Fibank Albania po zgjerohet në tregun Shqiptar me mbështetjen e fuqishme të Grupit rajonal Fibank.

Strategjia e zgjerimit synon punësimin e kapaciteteve profesionale, kredidhënien dhe suportin për bizneset e mira si edhe ofrimin e të gjitha produkteve e shërbimeve bankare për klientet individë.



Ne vitin 2018 pritët një vazhdimësi e zhvillimeve pozitive dhe një rritje e metejshme e bazuar në përpjekjet e vazhdueshme në ofrimin e produkteve inovative dhe të pershtatura për çdo tip klienti.





MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Çaji që shkrin gurët
në veshka brenda 2
javësh

KESHILLA



Çenkuela Hasa:
Këshilla, si të
ushqeheni shëndetshëm
gjatë pushimeve

Brikena Duva:

◆ Mjekja
stomatologe:
Mos i neglizhoni
kontrollet.
Higjiena, çelësi
kryesor i bukurisë




Si të kujdeseni për dhëmbët e shëndetin oral

"Metodat inovative në
trajtimin e sëmundjeve dentare"

Kuroni sëmundjet e rrugëve urinare me frutin e dardhës

Higjiena dentare është një komponent i rëndësishëm jo vetëm për shëndetin e dhëmbëve dhe të kavitetit oral, por për të gjithë organizmin në përgjithësi. Njerëzit duhet të ndërjegjësohen dhe t'i japin rëndësinë e duhur higjienës dentare pasi është çelësi kryesor për dhëmbë dhe mishra të shëndetshëm.



Mjekja stomatologe: Mos i neglizhoni kontrollet. Higjiena, çelësi kryesor i bukurisë

Brikena Duva:

Si të kujdeseni për dhëmbët e shëndetin oral

“Metodat inovative në trajtimin e sëmundjeve dentare”

Voltiza Duro

Dhëmbët e bardhë, të shëndetshëm e simetrikë luajnë një rol të rëndësishëm për të pasur një buzëqeshje të bukur. Por jo rrallëherë moskushtimi i vëmendjes së duhur ndaj shëndetit oral, bën që të shfaqen komplikacione nga më të ndryshmet, duke përfshirë këtu dëmtimin e dhëmbëve apo të mishit të tyre. Në një intervistë për suplementin “Life Pages” në “Gazeta Shqiptare”, mjekja stomatologe Brikena Duva tregon se sëmundjet e mishrave të dhëmbëve, nëse nuk trajtohen në kohë mund të shkaktojnë edhe humbjen e parakohshme të dhëmbëve natyralë. Më tej, Duva i bën thirrje pacientëve që t'i japin rëndësinë e duhur higjienës dentare e paraqet për lexuesit disa nga metodat inovative në trajtimin e dhëmbëve.

Sa e rëndësishme është higjiena dentare për shëndetin oral?

Higjiena dentare është një komponent i rëndësishëm jo vetëm për shëndetin e dhëmbëve dhe të kavitetit oral, por për të gjithë organizmin në përgjithësi. Njerëzit duhet të ndërjegjësohen dhe t'i japin rëndësinë e duhur higjienës dentare pasi është çelësi kryesor për dhëmbë dhe mishra të shëndetshëm.

Cilat janë pasojat që mund të sjellë dëmtimi i mishrave të dhëmbëve?

Sëmundja e mishrave të dhëmbëve është shumë e përhapur dhe një ndër shkaktarët kryesorë të humbjes së parakohshme të dhëmbëve natyralë. Nëpërmjet një higjienë të mirë dentare, dekursi i kësaj sëmundjeje do të jetë shumë më i ngadaltë. Përveç higjienës së përditshme shumë e rëndësishme është dhe pastrimi profesional tek mjeku stomatolog. Një metodë inovative krahas metodës tradicionale të pastrimit profesional

është përdorimi i aparaturës airflow, e cila pastron në thellësi cipat, xhepat dentare, urat si dhe implantet.

Sa shpesh rekomandohen vizitat tek mjeku stomatolog?

Vizitat dhe pastrimi profesional tek mjeku stomatolog rekomandohen të bëhen 2 herë në vit, pasi në këtë mënyrë mund të evidentohen në një periudhë të hershme problemet dentare dhe ndërhyrja në këtë fazë ndihmon që të mos agravohet problemi duke parandaluar ndërlikime të mundshme.

Si mund të parandalohet prishja e dhëmbëve?

Përveç higjienës së mirë, shumë i rëndësishëm në parandalimin e prishjeve të dhëmbëve janë edhe përdorimi i fluorit që ushqen dhe forcon dhëmbët. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i silantëve që aplikohen kryesisht tek fëmijët sapo dalin dhëmbëllat e përhershme, përdorimi i



Mjekja stomatologe, Brikena Duva

holla dhe fine që aplikohen mbi sipërfaqen e dhëmbit pa e dëmtuar atë duke i siguruar pacientit estetikë dhe qëndrueshmëri maksimale. Metoda të tjera të trajtimit të dhëmbëve janë edhe punimet pa metal, si koronat e plota porcelani, koronat Emax si dhe punimet me metale fisnike siç janë paladium porcelan, ar-platin porcelan.

Çfarë rekomandohet për zëvendësimin e dhëmbëve që mungojnë?

Zëvendësimi i dhëmbëve që mungojnë mund të bëhet me metoda të ndryshme siç janë implantet, urat dhe protezat dentare. Implantet dentare janë vida që vendosen në kockë dhe imitojnë rrënjën e dhëmbit natyral duke mos dëmtuar dhëmbët e tjerë në kufij me hapësirën siç mund të ndodhë në rastin kur realizohen urat. Gjithashtu, implantet ndihmojnë në qëndrueshmërinë e protezave totale në rastet kur bëhen proteza mbi implantet.

Cilat janë disa nga rekomandimet tuaja për një buzëqeshje sa më të bukur?

Pacientët duhet të përqendrohen gjithnjë e më tepër në ruajtjen e dhëmbëve natyrale, e ky është edhe mesazhi që dua të përcjell në mënyrë që të ndryshohet koncepti i bukurisë. Pra, mbronni sa më shumë dhëmbët tuaj, sepse buzëqeshja është aksesori më i mirë që mund të keni kurdoherë.

një diete të shëndetshme ushqimore me sa më pak karbohidrate si dhe eliminimi i veseve të ndryshme. Më mirë të parandalosh se sa të kurosh.

Cilat janë trajtimet inovative në fushën e stomatologjisë gjatë viteve të fundit?

Koncepti i trajtimit të dhëmbëve është gjithmonë e më shumë duke u afruar drejt trajtimeve që janë minimalisht invazive dhe që sa më shumë strukturën e dhëmbëve natyralë. Një ndër këto metoda janë fasetat Emax, të cilat janë punime shumë të



Voltiza Duro

Mjeku popullor: Simptomat kryesore të sëmundjes, meshkujt më të prekurit

Ylli Merja:

Çaji që shkrin gurët në veshka brenda 2 javësh

"Përdorni fierin e gurit e majdanozin e egër"

Guri në veshka është një masë e fortë që krijohet kur përbërësit e kalciumit ose kimikate të tjera nuk largohen nga epiteli renal i veshkës, por mbeten nëpër nefrone në formën e grimcave shumë të vogla. Më vonë këto grimca bashkohen me njëra-tjetrën duke formuar kristale që shkojnë 1-2 mm. Nëse nuk kuptohet nga shenjat e para të dhimbjes që jep veshka atëherë këto kristale vazhdojnë të tërheqin rreth vetes së tyre grimca të tjera. Pra, diametri i këtyre vazhdon të rritet dhe mund të shkojë deri në 4 mm. Pirja e pakët e ujit bën që qarkullimi i gjakut në veshkë të jetë më i ngadaltë, kështu që mundësia e qëndrimit të mikroelementeve të jetë më e madhe. Acidi urik i lartë në gjak bën që këto kristale në veshka të bashkohen me oksalatet e kalciumit dhe të formojnë gurëza në fillim më të vogla se kokrrizat e sheqerit.

LLOJET E GURËVE
Nga të gjithë llojet e gurëve kemi arritur në një konkluzion se këto ndahen në 3 grupe kryesore. Lloji i parë janë gurët e butë, baza e të cilëve është kalciumi e shkrihen lehtë, brenda 2-3 javëve dhe nuk japin komplikacion. Lloji i dytë janë gurët me fortësi mesatare, me përqindje më të madhe kalciumi. Koha e shkrirjes së tyre varet nga madhësia dhe shkojnë nga 2-5 javë. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë gurët e fortë që ngajjnë më shumë si gur qelqor me ngjyrë të errët që tregojnë se prania e silicit është e lartë. Në përgjithësi kur këta gurë janë në përmasa ata shpeshputen si bllok dhe dalin të pathërrmuar, ndërsa në raste të tjera dalin të shkëputur si ashkla dhe zgjatin 3-5 muaj. Kufiri më i mundshëm i formimit të gurëve në veshka më parë kanë qenë moshat 20-45 vjeç, ndërsa sot ky kufi është zgjeruar nga moshat 20-70 vjeç, por nuk përjashtohen edhe fëmijë të prekur nga kjo sëmundje. Ndërsa si përqindje formimi i gurëve në veshka ka ardhur duke u rritur. Më parë ka qenë 2-3% të predispozuar të formonin gurë në veshka, ndërsa sot kjo normë shkon



Ylli Merja

në 5-6%. Ndërsa seksi më i predispozuar për krijimin e gurëve janë meshkujt.

SIMPTOMAT DHE EKZAMINIMI
Në mënyrë të pakuptuar, kripëra të kalciumit të acidit urik dhe të mikroelementeve të tjerë vazhdojnë që të mbështillen rrotull këtij lëmshi. Në këtë pjesë, nefronet e veshkave ngjishen dhe fillojnë që herë pas here të japin dhimbje mes, djegie të urinës, ethe, temperaturë ose të vjella. Pra, nëse keni këto shenja është

mirë të kuptoni se ka diçka që nuk shkon me veshkat tuaja. Mund të bëhet një eko abdominale për të parë gjendjen e tyre. Nëse i lejmë në "qefin e tyre" atëherë gurët në veshka vazhdojnë t'i kapërcëjnë kufijtë 12-14-20mm. Këto lloj gurësh vazhdojnë të shtojnë dhimbjet në mes, në pjesën anësore të stomakut e djegie urine. Ndonjëherë gjak në urinë dhe tendencë për të urinuar sa me shpesh. Në disa raste gurët që janë 9-10-11 mm qëllonjë të dalin

nga veshka duke u futur në kanalet urinare. Ky është momenti kur guri në veshka jep dhimbje të padurueshme që shpesh qërohen me të vjella. Qetësuesi më i mirë i këtyre dhimbjeve të forta janë banjat me ujë të ngrohtë dhe përdorimi i çajrave bimorë ose pirja e ujit të shumtë 2-3 litra në ditë. Infeksionet e bajeve ndikojnë në mosfunksionimin e mirë të veshkës duke pakësuar sasinë e prodhuar të urinës në veshka. Pra, bakteret koke që shtegtojnë nga bajamet në veshka vështirësojnë punën e filtrimit të gjakut në veshka dhe për pasojë këto mikroelemente mbeten në hapësirat brenda veshkave duke formuar në fillim një re kristalorë dhe pastaj formohen kristale.

TRAJTIMI
Nga përvoja është vënë re se përdorimi i bimëve mjekësore jo vetëm që lufton infeksionet urinare, refluksat urinare në veshka, rënien e funksionit të veshkave, por edhe shkrirjen e gurëve në veshkë. Produkti më i mirë për shkrirjen e gurëve në veshka është një përzierje bimorë, e cila rrit fuqinë tretëse të çajit duke dobësuar në fillim strukturën e gurit në pjesën e jashtme të tij. Kjo përzierje bimorë konsiston në

rritjen e acidit në organizëm që të ndikojë ndjeshëm mbi sipërfaqen e gurit. Nëse personi që ka gurë në veshka pi 6-7 gota në dite nga përzierja bimorë kundër gurit të veshkave, atëherë është e sigurt që dalin fitimtar dhe realizojnë shkrirjen e gurëve në veshka. Pasi dalin gurët nga veshka përdorimi i çajit ndërpritet dhe mund të rifillohet pas një muaji vetëm 5-6 ditë. Kjo bëhet që në hapësirën ku ishte formuar guri në veshka të mos na riformonte sërish. Bimët që rriten në shkëmbinj, mund të shkrirjnë gurët në veshka. Pra, përdorim fierin e gurit ose gjarpin mjekësor, por edhe majdanozin e egër që rritet në shkëmbinj e trumzën e Robertit që rritet në gurët gëlqerore. Edhe lastari i ashës ka rezultate pozitive në shkrirjen e gurëve. Por ndonjëherë nuk mungon edhe kombinimi i disa bimëve së bashku. Për shembull përzierjen 2-3 lugë gjelle lëng limoni me një lugë gjelle vaj misri dhe kjo pihet gjatë ditës e shoqëruar me ujë.



Çenkuela Hasa

Çenkuela Hasa:

Këshilla, si të ushqeheni shëndetshem gjatë pushimeve

Vera është periudha kur të gjithë relaksohemi dhe pushojmë, por më së shumti shijojmë ushqimin. Ditët që jemi me pushime na duket sikur kaloritë nuk llogariten, por kur kthehemi në realitetin pas plazhit e argëtimit, përballemi me kilet e tepërta. Gjithkush dëshiron të shijojë pushimet, ushqimin, një gotë verë në mbrëmje apo edhe akuloret e ëmbëlsirat. Çenkuela Hasa, healthy blogger lifestyle, tregon për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" disa këshilla të vlefshme mbi ushqimin që duhet konsumuar gjatë stinës së verës, pa u shqetësuar për peshën.

PINI SA MË SHUMË UJË

Të pini sa më shumë ujë do të thotë se ju do jeni gjithmonë të hidratuar dhe trupi juaj nuk do të ketë uri që shpesh ngatërrohet me etjen. Uji ju ndihmon të ndjeheni të ngopur, gjithashtu, dhe në momentin që do të uleni në tryezë nuk do të keni një oreks më shumë se duhet. Mundohuni që të pini uji para vakteve kryesore, për të shmangur të ngrënë më shumë se normalja.

BALANCONI USHQIMIN ME LËVIZJET

Të balancosh ushqimin me lëvizjet do të thotë që të djegësh kalori dhe jo vetëm të marrësh. Që të mund të ruajmë balancat kur jemi me pushime duhet ti djegim kaloritë shtesë që marrim në ditë. Me pushime të gjithë marrim kalori shtesë sepse hamë disa gjëra më shumë sesa në një ditë normale dhe në këto shtesa mund ti eliminojmë nëpërmjet lëvizjeve dhe aktivitetit. Nëse jeni në plazh mund të notoni, mund ta bëni një shëtitje apo vrap 40 minuta buzë detit.

LËVIZNI SA MË SHUMË

Të kesh një litar kur je me pushime e ke të gjithë palestrenë me vete. Zë shumë pak hapësira në valixhen tuaj dhe me të mund të ushtroheni kudo dhe kurdo. Litari do të ishte shpëtimi juaj për të mos shtuar peshë gjatë pushimeve. Është nga ato aktivitete fizike kardiovaskulare që djeg shumë kalori dhe ushtron të gjithë muskujt e

trupit njëkohësisht. Nuk keni pse të bëni ushtrime këmbësh, krahësh apo barku kur jeni me pushime. Kjo do t'iu merrte më shumë kohë. Kështu përdorni litarin minimumi 20 minuta në ditë e hedhjet alternativin dhe me pushim midis.

PROVONI ÇDO GJË NË SASINË E DUHUR

Zakoni jonë më i keq është sepse e tepruam në sasi. I keni dëgjuar shprehjet "po plas" apo "mezi po marr frymë", janë më klasiket që përdorim kur jemi me pushime. Proveni dhe hani çdo gjë në sasinë e duhur, nga pak. Kjo nuk do ju bëjë



//

Të pini sa më shumë ujë do të thotë se ju do jeni gjithmonë të hidratuar dhe trupi juaj nuk do të ketë uri që shpesh ngatërrohet me etjen. Uji ju ndihmon të ndjeheni të ngopur, gjithashtu, dhe në momentin që do të uleni në tryezë nuk do të keni një oreks më shumë se duhet.

të humbi peshë por të ruani peshën tuaj. A nuk është kjo nga sfidat më të vështira me një rregull kaq të thjeshtë për tu arritur. **MBYLLENI DITËN ME NJË DARKË TË LEHTË** Nëse ju them të hani dhe provoni çdo gjë, këtë do ju sugjeroja ta bëni në pjesën e parë të ditës. Dhe darkën ta mbyllni me ushqime të lehta si një sallatë, një fileto, një smoothie, pak rizoto ose disa perime zgare. Kjo është zgjidhja më e zgjuar. Është një praktikë që e aplikoj vetë dhe ka rezultate fantastike. Këto ishin disa rekomandime që mund ti zbatoni me pushime por jo vetëm. Këto mbeten disa rregulla që për personat që duan thjeshtë të ruajnë peshën, janë shumë të vlefshme.

Këshilla



Efektet e mrekullueshme të pjeprit në organizëm

Pjeprë futet në kategorinë e frutave më të shëndetshme. Ai njihet për vetitë e tij kundër stresit. Përveç se lufton të nxehtin, parandalon edhe plakjen duke ndikuar pozitivisht tek lëkura dhe kockat, gjithashtu, ndihmon në ruajtjen e ngjyrës së lëkurës. Më poshtë po iu tregojmë disa nga vetitë e pjeprit.

1. Është antistres

Një studim i kryer në Itali ka zbuluar se pjeprë ka një antioksidant të njohur si superoksid dismutase, i cili transformon substancat e rrezikshme të trupit dhe largon stresin. Ajo mban vitaminën B6 që na ul acarimin në momente të caktuara. Gjithashtu shmang edhe problemet e

gjumit.

2. Është antioksidant

Pjeprë përmban vitaminën A dhe C të cilat gjenden në formën e karotenoideve, pigmenti natyral që i jep ngjyrën pjeprit. Kjo veti e frutit vonon plakjen.

3. Shëron plagët

Vitamina C që ndodhet te pjeprë ndihmon në formimin e kolagenit, e cila është e domosdoshme për shërimin e plagëve.

4. I domosdoshëm për kockat

Konsumimi i pjeprit mund të parandalojë edhe sëmundjen e osteoporozës, duke qenë se ky frut përmban në sasi të mëdha fosfor dhe kalcium.

5. Nxit qarkullimin e gjakut

Pjeprë favorizon qarkullimin e gjakut me anë të potasiumit që e ka në përbërje.

6. Aleati më i mirë i bukurisë

Ai ndihmon në tonifikimin e fytyrës dhe e bën të butë. Për këtë arsye përdoret shumë në produktet kozmetike. Është një përbërës shumë i mirë për lëkurat e thata. Duke e futur në frullator me pak ujë dhe qumësht, pastaj e fusim për pak minuta në frigorifer dhe kemi realizuar një maskë shumë të mirë për lëkurën.

7. Ndihmon në nxirjen e lëkurës

Pjeprë përmban betakaroten, i cili stimulon prodhimin e melaninës, e cila është përgjegjëse kryesore për ruajtjen e ngjyrës së çokollatës që merr trupit gjatë verës.

8. Mban trupin në formë

Fruti i pjeprit ka pak kalori, 100 gram pjeprë ka 33 gram kalori. Gjithashtu ka një sasi të madhe fibrash e cila jep ndjesinë e ngopjes te konsumatori.

9. Luftojnë fryrjen e barkut

Ky frut përmban tranzitin intestinal që nxit aktivitetin e zorrëve dhe stomakut, duke parandaluar fryrjen e barkut.

10. Ka vlera ushqyese të mëdha

Pjeprë ka 90% ujë duke bërë të mundur hidratimin dhe mbajtjen në formë të trupit duke qenë se 100 gram pjeprë përmban; 7.4 gr karbohidrate, 0.2 gr yndyra, 0.8 gr proteina dhe 0.7 gr fibra.



Kuroni sëmundjet e rrugëve urinare me frutin e dardhës

Dardha, me përbërjen pak të kokrriztë e shumë të ëmbël, konsiderohet një frut i preferuar nga masa. Por nga ky frut mund të parandalohen edhe një sërë sëmundjesh. Shumë studime kanë evidentuar se dardha është një frut me vlera të larta ushqyese, që e ndihmon organizmin në disa aspekte:

1-Dardha njihet për efekte qetësuese, kryesisht kundër djegieve të stomakut, gastriteve, kollitit apo kundër problemeve me zorrën e trashë.
2-Gjethet e dardhës përdoren kundër sëmundjeve të rrugëve urinare.

3-Dardha ka veti diuretike, që ndihmon në jash-tëqitjen e shpejtë të toksinave nga organizmi, duke rritur edhe prodhimin e acidit urik, që ndihmon së tepërmi personat që vuajnë nga artriti urik.

4-Ky frut ul kolesterolin në gjak.

5-Ndihmon në lehtësimin e dhimbjeve të kyçeve.

6-Dardha përmban një sasi mjaft të pasur me vitaminën A, C, K, B2, B3 dhe B6. gjithashtu ky frut lidhet dhe me parandalimin e osteoporozës.

7-Me lëngun e dardhës mund të qetësoni fytnin e irrituar nga kolla.

8-Dardha është shumë e pasur me fibra dhe e mbushur me veprimtari ushqimore antioksidantësh.

9-Cipa e dardhës bën mirë për pastrimin e veshkave, ndërsa lëngu që përthohet nga zierja e degëve të dardhës ndihmon në uljen e temperaturës.

10-Acidi hidroksicinamik, që gjendet tek dardha parandalon kancerin e stomakut dhe mushkërive.



NGJARJET E LUFTES EKZEKUTIMI

1943, vrasja e deputetit Hysni Toska nga një mafie lokale komunisto-balliste

Nga Ylli Polovina

Mes një punë të nisur që në mes të vitit 1971 për krijimin e një arkive personale me zhvillime nacionale dhe ndërkombëtare të kohës, por edhe me të dhëna për Luftën Nacionalçlirimtare në qytetin e lindjes, në Berat, në 28 mars 1977 kam kryer edhe një bisedë të regjistruar dhe më pas të zbardhur në letër, me ish-partizantin C. Xh.

Ky njihet si njëri i matur dhe realist, jo tip propagandistik.

Mes të tjerash ai tha: "Në 39-tën Hysni Toska kishte ngritur mbi prefekturë një mitraloz, gjoja donte të godiste aeroplanët italianë".

Njëkohësisht u shpreh se: "Hysni Toska ishte në karrocë. I hodhën një bombë dhe vetëm e plagosën. Ishin dy veta".

Kur më erdhën këto dy të dhëna shumë të rëndësishme për këtë person që nuk që beratas dhe për historinë lokale, kërkova në Muzeun e Luftës së qytetit ndonjë informacion më të plotë.

Atje ai nuk përmendje fare. Zinte vend një tjetër emërkeq, me të njëjtin mbiemër: Isa Toska. Këtë gjendje e rivefikoi për qëllimet e këtij shkrimi pak kohë më parë edhe studiuesja Marea Guga, autore librash historikë me frymë bashkëkohore, pas viteve nëntëdhjetë për shumë kohe edhe drejtore të këtij Muzeu.

Doemos që këta dy, Hysni dhe Isa, qenë persona të ndryshëm, por atë kohë opinioni gjithkund, zyrtar apo popullor, që nga ish-veteranë të Luftës e deri politikë apo drejtues vendorë, shprehej pa mëdyshje dhe pa asnjë dëshirë për ta verifikuar lidhjen e tyre fisnore: qenë xhaxha dhe nip, kriminelë të njëlojtë. I pari ishte vrarë nga partizanët në Fier, i dyti po nga partizanët në Berat.

Ngjarja e pazbardhur e Beratit gjatë luftës dhe nderi i vënë në vend

Vrasja e të dyve konsiderohej punë pa asnjë mëkat: armikut i duhej dhënë plumbi ballit. Me kaq organeve zyrtare të kohës dhe shumë njerëzve ndërgjegjia u flinte rehat. Mirëpo "diktatura proletare" do të rrënohej dhe me hapjen e sistemit shoqëror do të ndodhte një rizgjim i vetëdijës kombëtare për ta çliruar historiografinë, sidomos atë të Luftës së Dytë Botërore, nga një gjysmë shekulli censurim dhe fshehjeje të rëndë të së vërtetave të plota. U kuptua shumë shpejt, si vetëtimë, se vrasja e Isa Toskës që një punë e vyer dhe ajo e Hysni Toskës një krim i përbindshëm. Por kjo e fundit, nga që ishte propozuar thellë, duhej provuar me dokumente të shkruara dhe dëshmi gojore një për një. Kështu për qëndrimin ndaj rivlerësimit apo jo të Hysni Toskës ndodhën dy zhvillime paralele: njëri në Fier dhe tjetri në Berat. Qenë kreu të pangjashëm, madje të kundërt.

Në 1994, Shyqyri Toska, një nga pasardhësit e Hysniut, botoi në gazetën "Liria", organ i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë, shkrimin "Nacionalistët i shquar Hysni Toska". Në 30 nëntor 1994 rehabilitimi historik hovi më lart: Hysni Toskës iu dha e drejta e statusit të ish-të Përndjekurit Politik. Në 13 janar 1998, TV

Klan përkujtoi përvjetorin e krijimit të xhandarmërisë shqiptare dhe e radhiti Hysni Toskën ndër komandantët e saj të parë. Në 13 janar 2003, me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit, figura e Hysni Toskës u përmend akoma më shumë. Në vitin 2007, në aktivitetin e përbashkët të Muzeut Historik Fier dhe Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, prof. dr. Liman Varoshi mbajti një kumtesë ku theksoi se Hysni Toska ishte "figurë kombëtare me orientim të qartë patriotik." Në 10 nëntor të këtij moti, 2007, ish-partizani L Lazar Bane, në ndjenjë pendese, publikoi në "Zërin e Popullit" shkrimin "Hysni Toska, krenari për kombin". Në vitin 2008, prof. dr. Muharrem Dezhgiu botoi në revistën shkencore "Studime Historike" një artikull me titull "Aspekte nga veprimtaria politike e Hysni Toskës në vitet 1912-1943". Në 2010 Këshilli Bashkiak i Fierit (drejtuar nga socialistët), i vuri emrin e tij një rrugë, kurse në 2012 në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë, Këshilli Bashkiak i Roskovecit (drejtuar nga Partia Demokratike), i akordoi atij titullin "Qytetar Nderi".


Por kulmimi i madh i rivlerësimit ndodhi këto ditë kur studiuesi Nuri Plaku, drejtor i Muzeut Historik të

Fierit, botoi librin 295 faqesh "Hysni Toska në fokus historik" Për këtë temë në cilësinë e mbështetjes dokumentare dhe të argumentimit shkencor është tërësisht shterrues, i pakundërshtueshëm. Në nivelin e të shkruarit ky libër mbetet një krijim me dhunti rrëfimi të shndritshëm epik. Ky botim, përveç diturie, duhet konsideruar ngjarje e spikatur shoqërore, politike dhe madje demokratike. Ai e çliron përfundimisht kujtesën tonë kombëtare nga diversioni që i është bërë asaj me kryerjen dhe fshehjen e një krimi të madh: vrasjen e pabesë të një deputeti plak dhe të djalit të tij ende pa mbushur 17 vjeç.

FIJET E INTRIGËS

Po të shohësh 364 faqet e daktilografuara të historikut të rrethit të Fierit, përgatitur para nëntëdhjetës, atje sapo për herë të parë përmendet emri i Hysni Toskës (konkretisht si bashkëpunëtor i ngushtë i Ismail Qemalit), në shpjegim të këtij fakti autorët e tekstit poshtë faqes (me numrin 9) kanë shkruar: "Hysni Toska, ish-kolonel i Zogut, armik i popullit".

Ndërkaq në Berat kjo logjikë e të kaluarës njëpartiake nuk ka ndryshuar edhe për më shumë se një çerek shekulli nga nisja e jetës së Shqipërisë pluraliste. Dëshmie e fundit për këtë është një libër i ish-drejtuesit partizan dhe aktualisht kryetarit të Komitetit të Veteranëve të Luftës së Beratit, Orhan Frashëri. Titullohet "Shpiragu i trimërisë". Mes




Hysni Toska

të tjerash, duke rrëfyer për batalionin e Shpiragut dhe të Malit të Bardhë, ku që komisar, ai shkruan: "Forcat e batalionit morrën pjesë në luftimet për çlirimin e qytetit të Beratit dhe në disa luftime të tjera. Gjatë qëndrimit në qytetin e Beratit, batalionit iu ngarkua detyra për të goditur dhe asgjësuar disa agjentë dhe spionë që ishin vënë në shërbim të fashizmit. Duke u mbështetur në vullnetin e popullit, Këshilli Nacionalçlirimtar i qytetit e Shtabi i Qarkut kërkuan nga "Balli Kombëtar", që të dorëzonin para gjyqit të popullit kriminelët e luftës. Por krerët e Ballit e refuzuan këtë kërkesë. Një indinjatë të thellë në popull, shkaktoi mbrojtja nga ana e Ballit Kombëtar e togerit të milicisë fashiste Mehmet Demiri, që kishte torturuar e masakruar të rinjtë e qytetit dhe popullin e Shpiragut..." Pak më tej autori shtoi: "Meqenëse krerët e

"Ballit" refuzuan për t'ia dorëzuar toger Mehmet Demirin Shtabit të Qarkut, ky ngarkoi një togë të partizanëve nga batalioni i Malit të Bardhë, për t'u dorëzuar, por toger Mehmeti nuk pranoi, dhe më pas nga shkëmbimi i zjarrit të armëve ai mbeti i vrarë". Menjëherë në vijim: "Po në qytetin e Beratit nga forcat e batalionit Mali Bardhë u rrethua shtëpia e komandantit të Ballit, oficerit të lartë dhe deputetit kolonel Hysni Toska, i cili luftoi deri në fund, sa më në fund u vra nga partizanët".

Shkon më tej në rrëfimin e vet 94 vjeçari Orhan Frashëri: "Në lagjet e qytetit u kap dhe u vra agjenti dhe ndihmës federali i kështurës Hajri Borshi. Më vonë u kap dhe u pushkatua kapteri i policisë fashiste Gjin Guce. Të dy këta agjentë dhe njëkohësisht kuadro në policinë sekrete fashiste, akuzoheshin për tortura dhe vrasje ndaj të rinjve të qytetit. Vrasja e këtyre



Opinion *i* Ditës

Politikat e zhvillimit dhe reforma rregullatore

Nga Elvis Zaimi


Ekspert i të drejtës financiare

(vijon nga faqja 1)

... dhe teorive që synojnë zhvillimin e një vendi, u përqendrua tek hartimi dhe zbatimi i politikave të përshtatshme zhvillimore, të mbështetura nga ndihma dhe asistenca ndërkombëtare, të cilat spikatin me paradigmen teorike të njohur me emrin "Konsensusi Uashingtonit", e cila përcakton një set parakushtesh për zhvillimin ekonomik të një vendi, të tilla si stabilizimin, liberalizimin dhe privatizimin. Paul Krugman, i përshkruan në këtë mënyrë politikën zhvillimore të "Konsensusit të Uashingtonit", paradigme e zhvilluar në vitet 90' "Nëse një vend ka liberalizuar tregtinë, privatizuar ndërmarrjet shtetërore, dhe ka stabilizuar kursin e këmbimit, ai vend ka hedhur edhe themelet e rritjes ekonomike të bazuar tek norma të larta kthimi nga investimet". Gjithsesi, "çelësi i suksesit" të këtyre politikave ekonomike zhvillimore është krijimi dhe mbajtja e një mjedisi rregullator, në të cilin ekzistojnë incentivat për funksionimin e këtyre politikave. Thënë ndryshe, politikën ekonomike zhvillimore, edhe kur janë të përshtatshme, janë të destinuara të dështojnë, nëse nuk ka një treg eficient të cilin e garantojnë institucione efektive dhe të drejta.

Në Shqipëri, pas viteve 1990 ndjekësit dhe ithtarët e Hayek, Friedman, dhe të shkollës së Çikagos së ekonomisë, u shndërruan në partizanë të teorisë së "terapiës shock", duke besuar se privatizimi dhe liberalizimi i menjëhershëm i ekonomisë, i shoqëruar me stabilizimin monetar dhe fiskal, do të krijojte një ekonomi tregu funksionale, që në mënyrë të vetvetishme, të natyrshme, dhe spontane do të çonte shqiptarët, të paktën jo drejt begatisë, por drejt standardeve të krahasueshme të mirëqenies me vendet fqinje dhe evropiane. Fatkeqësisht, nuk iu kushtua rëndësia e duhur ndërtimit dhe konsolidimit të institucioneve të reja politike dhe të qeverisjes ekonomike, pra organizimit eficient të jetës politike dhe ekonomike të vendit, në sistemin kapitalist.

Teori të tilla rezultuan një "iluzion vrastar", që e manifestoi veten fillimisht me krizën e vitit 1997. Gabimi themelor i politikave ekonomike zhvillimore të forcave politike të djathta para vitit 1997, ishte braktisja e paarsyeshme, madje "përqeshja dhe tallja", me strukturat institucionale të ish-shtetit komunist, të cilat ishin të papolitizuara dhe profesionale, ose që, nëse do t'u ishin nënshtruar reformave, mund të vazhdonin të funksiononin në mënyrë të pran-



ueshme edhe në shtetin demokratik. Ndryshimet komplekse shoqërore që pësoi shoqëria shqiptare pas viteve 1990 në shumë raste u zhvilluan jashtë rregullave të lojës demokratike, madje edhe "në mënyrë okulte", pikërisht sepse jetës së vendit i munguan institucionet efektive. Politikën e rritjes ekonomike, sado të përshtatshme, nuk mund të kenë asnjë lloj impakti në zhvillimin ekonomik të vendit, nëse nuk ekzistojnë institucionet efektive që krijojnë incentivat e duhura. Pas viteve 1990, Shqipëria i braktisi politikën e dështuara centralizuese dhe stataliste në ekonomi, dhe nën mbikëqyrjen dhe asistencën e FMN hartoi dhe zbatoi politikën të stabilizimit makroekonomik të përshtatshme. Pavarësisht kësaj, Shqipëria vazhdon të mbetet një vend "dëshpërimisht i varfër", d.m.th politikën ekonomike zhvillimore nuk kanë dhënë rezultate domethënëse. Vendi braktisët në masë nga populli i saj, veçanërisht nga njerëzit e arsimuar dhe pro-

fesionistët e kualifikuar. Shqiptarëve të thjeshtë u mungojnë incentivat për të ndërtuar një jetë dinjitoze, d.m.th "të mirë dhe të drejtë".

Pritshmëritë e popullit shqiptar, me rënien e komunizmit, ishin shumë herë më të larta, sesa ofron realiteti zhgënjyes i përditshëm. Në këtë kuptim, qeveria aktuale, në të njëjtën linjë me qeveritë e mëparshme të majta apo të djathta, vazhdon të vërë në zbatim politika ekonomike të rakorduara me FMN, por në agjendën e reformave ka një mungesë të madhe, mungon "reforma rregullatore e institucioneve". Forca politike në pushtet ka shpallur sloganin "Do të bëjmë shtet", por nuk ka bërë të qartë ndonjë vizion programatik sesi do të sendërtohet "bërja e shtetit". Vullneti politik, nëse është real dhe i sinqert, duhet të shoqërohet me përpjekje konkrete për t'i dhënë jetës së vendit "frymëmarrjen demokratike institucionale".

Dështimi i institucioneve shqiptare pas vitit 1990, ishte më i

dukshëm në fushën e rendit publik, të të drejtave të pronësisë, në arsim, shëndetësi, dhe në sektorin bankar dhe financiar. Në Shqipëri nuk ka ndodhur asnjë reformë institucionale e mirëfilltë, në rastin më të mirë ka pasur "arnime legjislative me stof të huazuar nga direktivat e BE-së".

Ndërtimi i një shteti të respektueshëm, mbetet edhe sot një sfida e forcave politike që kërkojnë të qeverisin këtë vend.

Studimi i ngjarjeve të vitit 2014, të cilat eidentuan se qeverisja e brendshme e Bankës së Shqipërisë i ngjante një "gërmadhe institucionale", kryesisht falë papërgjegjshmërisë së Këshillit të saj Mbikëqyrës, dëshmon edhe njëherë se Shqipëria ka nevojë për një shtet normativ të vlerave objektive kushtetuese, dhe një qeverisje ekonomike teknokratike dhe meritokratike, duke nxjerrë jashtë lojë dhe neutralizuar jeta demokratike e vendit efektet malinjë të "pseudo-elitës politike".

HOROSKOPI

DASHI

Marsi nuk do të jetë shumë i favorshëm sot dhe kështu do t'ju duket se kush ju qëndron pranë ju kundërshton. Kërkoni një bisedë sqaruese. Ndërsa jeni nën ndikimin e Marsi, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

DEMI

Mjalton të mësoni të vëzhgoni, do të zbuloni se jeta në çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore; jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshihen shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

BINJAKET

Nganjëherë jeni shumë të shpejtuar dhe drastikë. Bëni mirë ta merrni parasysh këtë gjë, sepse ndodh që persona rreth jush të shqetësohen. Vazhdoni të angazhoheni për punët profesionale, por tejlini vetes edhe pak kohë të lirë dhe shijoni emocione të ndryshme nga e zakonshja.

GAFORJA

Hëna do të bashkëveprojë ndjeshëm me planetë të ndryshme. Disa paqartësi në fillim të ditës, por më vonë gjithçka do të sqarohet në mënyrë më të mirë. Përdorini mënyra të cilat ju përshiaten më shumë: mirësjellje, takt, mirësi, dashamirësi.

LUANI

Sot këshillohet të përballosi çështje të pazgjidhura në fushën e dashurisë. Duhet t'ju shqyrtoni gjërat nga çdo këndvështrim, pa u fshehur pas iluzioneve. Nëse një epur ju kërkoi të punoni përtej kompetencave tuaja, qëndroni të qetë dhe refuzoni.

VIRGJERESHA

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijin momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.

PESHORJA

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar në kritertet e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Ndërkaq Hëna mund të tregohet dinake, dhe sot do të keni si situata pozitive ashtu edhe tensione.

AKREPI

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijin momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.

SHIGJETARI

Saturni krijon një premisë të shkëlqyer për anën profesionale. Intuitat e castit do të bashkohen me aftësinë për të konkretizuar projektet. Do të vëzhgoni me vëmendje sjelljen e një personi që kërkoi t'ju bëjë të besoni se është çfarë nuk është në të vërtetë.

BRICJAPI

Sot do të ndiheni disi të bllokuar dhe do të lëvizni pak më vështirë. Ndërkaq, nuk do t'ju mungojë rezistenca dhe pozitiviteti. Do të merrni në dorë një çështje që ka ngjetur dhe do t'ju jepni zgjidhje me një ndërmirë të zgjuar dhe të ekuilibruar.

UJORI

Sot do të keni surpriza të këndshme dhe do të jeni shumë aktiv. Sot me të vërtetë do t'ia kaloni bukur! Do të keni dëshirë t'i përkushtoheni studimit të lëndëve të reja; mbi të gjitha do të preferoni shkencën dhe matematikën.

PESHQIT

Me Neptunin dhe Marsin armiqësor nuk do të jeni në humor të mirë. Do të kundërshtoni çdo që thoni. Mos e ekzagjeroni, ndërkaq! Do të jeni i tendosur dhe personi i zemër do të vendosë t'ju shpërfillojë, duke ju lënë të vetëm të tejkaloni shqetësimin që keni.

Fjalëkryqi (1)

10x10 crossword puzzle grid with numbers 1-55.

- HORIZONTAL
1. Gjyrmë arkivi.
4. Sikur janë në krye.

- 37. Ishte lumi i harresës.
39. Ishte xhelozja e Olimpiti.

- VERTIKAL
1. Ai dhe ajo.

- 14. Janë pasanikë.
15. Munë të jenë republikë.

Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL
1. Jo të gjitha bëjnë mjalte.
6. Janë skuadra.

10x10 crossword puzzle grid with numbers 1-49.

- VERTIKAL
1. Pret shumë fëmijë.

Gjeni ndryshimin

Two grids of playing cards for a matching game.

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Two more grids of playing cards for a matching game.

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4x4 Sudoku puzzle grid with numbers 1-9.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Completed 4x4 Sudoku grid.

Vertical crossword puzzle with words like ARKUA, ASTRO, AMAR, DIANA, HIKET, OLSK.

Argëtim filozofik

- Hakmarrja është një lloj drejtësie primitive, në të cilën tërhiqet natyra njerëzore. Detyra e ligjit është të përqipet ta zhdukë atë.



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

Cryptogram puzzle with letters and numbers in a grid.

- Është mirë të keni para dhe gjërat që paratë mund të blejnë, por është gjithashtu të rëndësishme të siguroheni që nuk keni numër atë që paratë nuk mund të blejnë.

Ehënie të menjëhershme

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

